# FJALEBURRI 2016

# ANGAZHIMI I DJEMVE DHE BURRAVE KUNDER DHUNES ME BAZE GJINORE

Fjale Burri



# RRETH PROJEKTIT

FjalëBurri është zhvilluar në mënyrë të pavarur, në kuadrin e iniciativave kombëtare nën ombrellën "Nxitja e ideve të reja për ndërtimin e partneriteteve midis burrave dhe grave për barazi gjinore dhe një shoqëri të lirë nga dhuna". Ky projekt u zbatua nga Qendra Ura, në bashkëpunim me organizatat lokale Argitra Vizion Peshkopi dhe Qendra Shqiptare e Grave me Probleme Sociale, Durrës.

**Falenderim të veçantë për të gjithë burrat, djemtë, gratë dhe vajzat kontributi i të cilëve ka qenë thelbësor ne suksesin e projektit.**

# NË LIDHJE ME KËTË RAPORT

Ky raport dokumenton aktivitetet dhe gjetjet kryesore nga studimi i titulluar FjalëBurri, i ndërmarrë në vitin 2015 dhe 2016. Ky ishte një hulumtim me pjesëmarrje i projektuar dhe zhvilluar në dy rrethe, Dibër dhe Durrës, si dhe online. Raporti gjithashtu paraqet konkluzione dhe rekomandime për punën e ardhshme për të angazhuar burrat dhe gratë në partneritet për barazinë gjinore dhe një shoqëri të lirë nga dhuna.

Falenderime Znj. Entela Lako, UNDP Shqipëri, Znj. Edlira Papavangjeli, UNDP Shqipëri dhe Znj. Elona Dini, UNDP Shqipëri për komentet dhe sugjerimet.

**Udhëheqëse Ekipi dhe Autore:** Dr. Enkeleida Tahiraj

**Ekipi Hulumtues:** Dr. Juli Vullnetari
Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani
Znj. Erinda Malaj, MA.

Koncept Ideja: West One Consulting

Dizajn dhe Print: EDER Studio,Tiranë.

© Copyright 2016 Ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të botohet pa lejen e autorit. Megjithatë, përdorimi i ndershëm i të dhënave lejohet nëse shoqërohet me njohjen te autorësisë.

# MIRËNJOHJE

**Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ose të Kombeve të Bashkuara (OKB).**

SWEDEN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

United Nations ALBANIA

UNDP
*Empowered lives. Resilient nations.*

# AKRONIMET

PK Plani Kombëtar Shqiptar për Përfshirjen e burrave dhe djemve si Partnerëve për Gratë dhe Vajzat në Stereotipet sfiduese Gjinore dhe Lufta kundër Dhunës me Bazë Gjinore

CEDAW Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

KDF Konventa për të Drejtat e Fëmijës

ESGJ Edukimi Seksual Gjithëpërfshirës

DHBGJ Dhuna me Bazë Gjinore

GEM Shkalla e Matjes së Normave të Barazisë Gjinore tek Meshkujt

GEMS Lëvizja e Barazisë Gjinore në Shkolla

INSTAT Instituti i Statistikave

ICRW  Qendra Ndërkombëtare për Kërkime mbi Gratë

IMAGES Hulumtimi nderkombetar i burrave dhe barazisë gjinore

IPV Dhuna nga Partneri Intim

LGBT Lesbian, Gay, Biseksual dhe Transeksualë

MAP Burrat si Partnerë

PSH Policia e Shtetit Shqiptar

SRHR Shëndeti Seksual dhe Riprodhues dhe të Drejtat

UN Kombet e Bashkuara

PNUD Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

VAW Dhuna ndaj grave

**Ky studim është autorizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri (UNDP Shqipëri) me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë.**

**Programi i UNDP për Barazinë Gjinore punon ngushtë me qytetarët për të nxitur kërkesën e publikut për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen e burrave dhe djemve si Partnerë për Gratë dhe Vajzat kundër Stereotipeve sfiduese Gjinore dhe Lufta kundër dhunës me bazë gjinore, si pjesë e fushatës UNiTE të Sekretarit të Përgjithshëm, po thyen mitin se DHBGJ është vetëm çështje e gruas.**

**Që nga viti 2012 fokusi i këtyre fushatave është zhvendosur nga aktivitetet "njihni të drejtat tuaja" drejt një lëvizje për përfshirjen e burrave dhe djemve në luftën kundër dhunës ndaj grave. Kjo ka patur një ndikim të gjerë, me një numër në rritje të njerëzve të përfshirë në këtë lëvizje. Mbi 1000 djem dhe vajza të reja kanë përfituar direkt nga fushata dhe mbi 400,000 njerëz nga komuniteti kanë marrë mesazhin përmes mediave sociale dhe elektronike.**

# PËRMBAJTJA

Ky raport dokumenton aktivitetet dhe gjetjet kryesore nga studimi dhe punëtoritë.

Ai gjithashtu paraqet konkluzione dhe rekomandime për punën e ardhshme për të angazhuar burrat dhe djemtë në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

I Arsyetimi dhe metodologjia për angazhimin e djemve adoleshentë dhe të rinjve për barazinë gjinore, si dhe për nevojat e tyre.

II Shqyrtimi i çështjeve kryesore, përfshirë DHBGJ në Shqipëri, dobësitë specifike gjinore dhe ndikimi në jetën e grave dhe vajzave.

III Puna e ndërmarrë me djemtë dhe burrat për të zhvilluar angazhimin me çështjet, nga investigimi tek aktivizmi.

IV Gjetjet kryesore cilësore dhe sasiore nga seminaret dhe anketa.

V Rekomandimet dhe drejtimet e mundshme për ndërhyrje të mëtejshme.


7 PËRMBLEDHJE

9 INFORMACION

10 PËRSIATJE

12 DHBGJ NË SHQIPËRI

15 NDËRTIMI I STUDIMIT

18 STUDIMI ME PJESËMARRJE

22 GJETJET E STUDIMIT

38 REKOMANDIME

# PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

FjalëBurri është një studim mbi qëndrimet e meshkujve ndaj gjinisë dhe dhunës në Shqipëri.  Fillimisht u krye në 2012-13. Ky studim i dytë është realizuar në 2015-16 dhe përmbledh periudhën e "16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore 2015". Aktivitetet e projektit u përqëndruan në aktivitete kërkimore me pjesëmarrje të djemve, burrave, grave dhe vajzave në rajonet e Dibrës dhe Durrësit.

Projekti u konceptua si një studim në qëndrimet që do të informojnë drejtimet e ardhshme për ndërhyrjet që përfshijnë burrat dhe djemtë kunder DHBGJ në Shqipëri. Qëllimi ishte që të angazhohen burrat dhe djemtë me këto çështje, për të gjetur mënyra për të promovuar lidershipin për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe për të promovuar barazinë gjinore. Në thelb të projektit ishte koncepti i ndikimit që kanë pakicat e përkushtuara në arritjen e ndryshimeve shoqërore.

Konkluzionet do të nxirren për të vlerësuar ndryshimet e evidentuara. U kryen seminare edukative mbi çështjet e DHBGJ me pjesemarrje të një shumice burrash dhe djemsh. Metodologjia u bazua në hulumtimet e veprimit me pjesemarrje, me aktivitete të strukturuara në mënyrë që të:

• Ftojmë: Të ftojmë për të marrë pjesë në projekt burra dhe djem nga të gjitha sferat e jetës.

• Të Përfshijmë: Të angazhojmë burrat dhe djemtë në gjetjen e mënyrave për të parandaluar dhunën ndaj grave.

• Të Frymëzojmë: Zhvillim të rrjeteve të burrave dhe djemve që do të udhëheqin rrugën per të sjellë ndryshimin mes moshatarëve të tyre dhe të sigurohen mjetet për ta bërë këtë.

Vlera e shtuar e studimit si hulumtim formues qëndron në faktin se shërben si bazë për studime dhe ndërhyrje të ardhshme. Megjithatë, kufizimet lindin për shkak të shkallës të vogël të kampionit të studimit.

Raporti propozon disa drejtime për zhvillimin e aktivizmit të meshkujve, koordinimin, dhe për ti bërë ata koherent me çështje të tjera të së drejtave. Rekomandimi kryesor është për zhvillimin e përqasjeve të sinkronizuara gjinore, ndërsa ende ruhen identitete të dallueshme për burrat dhe djemtë; një fokus në potencialin për ngritjen e vetëdijes dhe aktivizmin në mjediset formale dhe informale arsimore;  një fokus në ndërhyrjet që promovojnë një konceptim modern të atësisë që përfshin rol ne përkujdesjen e fëmijeve, së bashku me forcimin e edukimit seksual dhe riprodhues.

Ka ende shumë për të bërë për të zgjeruar ndërgjegjësimin dhe zhvillimin e të kuptuarit publik të çështjeve të DHBGJ. Për të arritur një ndryshim të qëndrueshëm, kjo punë është më e rëndësishme të bëhet me të rinjtë dhe me anë të metodave që reflektojnë vlerat e tyre të përbashkëta. Për fat të mirë, ky është edhe grupi më i hapur për këtë vizion. Me një përqëndrim të fuqishëm në këtë audiencë, dhe 'duke bërë më shumë nga ato aktivitete që duket se japin rezultat",  mund të jemi optimist se arritjet e iniciativave të fundit, për të mirën e të githëve, mund të cohen më tej duke e bërë DHBGJ të papranueshme në Shqipëri.

# INFORMACION MBI PROJEKTIN

**Projekti FjalëBurri ka për qëllim të shërbeje si bazë informimi për ndërhyrjet që adresojnë DHBGJ në Shqipëri dhe që frymëzojnë aktivizmin në këto çështje. Projekti kishte dy komponentë kryesorë:**

**• Studim me bazë pyetësori mbi qëndrimet e meshkujve**
**• Hulumtim Veprimi me pjesëmarrje me qëllim mbështetjen e meshkujve dhe nxitje të aktivizmit.**

Për këtë qëllim, para angazhimit të burrave dhe djemve mbi çështjet kyçe, u krye një studim paraprak, i lokalizuar, mbi perspektivat e meshkujve, qëndrimet dhe vlerat. Të kuptuarit qartë të cështjes është thelbësore për një ndërhyrje që synon promovimin e barazisë gjinore. Gjithashtu ofron një bazë për zhvillimin e aktivizmit të burrave dhe djemve në këto çështje.

Programi u shtri ne tri faza: "të ftojmë, të përfshijmë dhe të frymëzojmë 'burrat dhe djemtë në marrjen e masave kundër DHBGJ. Për të arritur këtë, së pari synuam të kuptojme nivelin e vetëdijes dhe perceptimet aktuale për dhunën, rolet gjinore, si dhe çështjet e të drejtave. Me këtë dije, ne mund të kuptojmë sinjalet informative dhe sociale që angazhojne, ose bëjnë indiferentë, burrat dhe djemtë.

Edhe pse nuk ishtë një qëllim në vetvete matja e ndryshimeve në qëndrime në lidhje me përdorimin e dhunës kundër grave para dhe pas studimit, disa krahasime me studimin e parë janë bërë. Vetë-raportimi gjatë dhe pas aktiviteteve në grup dhe fushatës, tregoi rritje të ndërgjegjësimit dhe të diskutimit mes të rinjve dhe të rriturve rreth roleve gjinore dhe barazisë. Në rastet kur kjo u evidentua, u krye dhe nje vlerësim krahasues.

Projekti:
• U shtri në dy zona pilot me nxënës dhe prindër ku u shpërndanë 1600 pyetësorë, 1417 prej atyre të plotësuar  rezultuan të vlefshëm. Prej tyre 694 djem dhe vajza dhe 723 prindër në Durrës dhe Dibër. Përveç kësaj, një fushatë në internet arriti në mbi 9,500 vizitore përmes një faqe interneti dhe rrjeti social. Kjo na mundësoi të matim nivelet e angazhimit me komunikimin në internet dhe për të modeluar influencën në internet dhe ndarjen e informacionit.

• Angazhoi 87 pjesëmarrës në punëtori edukative dhe të komunitetit. Këto u zhvilluan në një mjedis në të cilin tema e identitetit gjinor dhe marrëdhëniet mund të hulumtoheshin nga pjesemarrësit  pa frikë apo presion.

• Frymëzoi pjesëmarrësit në të gjitha aktivitetet, burrat dhe djemtë, të japin fjalën për të vepruar për ndalimin e DHBGJ dhe për të shprehur indinjatën e tyre ndaj kësaj çështje. Pjesëmarrësit propozuan ide për të zgjidhur problemin e dhunës kundër grave në komunitetet e tyre. Duke rikujtuar shprehjen 'burri lidhet prej fjale' - jep Fjalën e Burrit, thuaj Jo dhunës - ne kërkuam nga pjesëmarrësit të zotohen në angazhimin kundër dhunës në familje dhe komunitetet e tyre. Ndryshimi nis me hapa të vegjël.

# PËRSIATJE

**Angazhimi i djemve dhe burrave është sa i rëndësishëm po aq edhe i domosdoshëm për të arritur barazinë e plotë të grave dhe vajzave. Kjo gjithashtu mund të sjellë ndikime pozitive të përhershme ndaj vetë burrave dhe djemve; procesi i diskutimit dhe tejkalimit të normave të pabarabazisë, dhe të dhunës që kufizojnë jetën e grave dhe vajzave mund të jenë të çliruese për vetë djemtë dhe burrat.**

Sigurisht, zakonet që përkufizojnë ate se çfarë do të thotë të jesh burrë shpesh dëmtojnë gratë dhe vajzat. Megjithatë, burrat vetë mund të vuajnë ndikime të dëmshme për shkak të këtyre pabarazive, veçanërisht kur ata kërkojnë të shkelin jashtë kufijve të atyre që shoqëria i konsideron "të pranueshme".

Shqipëria ka parë shumë progres në zhvillimin e kuadrit për të drejtat e grave. Padyshim, megjithatë, në krahasim me gratë, burrat mbeten në pozita dominuese në sferat publike dhe private. Dhe vërtetë, ndërsa ky studim po kryhej, disa raste të grave që vuajnë abuzime si në familje dhe në hapësirën publike po raportoheshin në media.

Dëshmi nga e gjithë bota tregojne se brenda strukturave të pushtetshme të kahershme, burrat dhe djemtë mbajnë pikëpamje shumë të ngurta për gjinine, rolet e meshkujve dhe atë se "çfarë do të thotë të jesh burrë". Kjo mund pa dyshim ul nivelin e zhvillimit shoqëror dhe barazisë gjinore. Megjithatë, si arrin te kthehet kjo në një kulturë dhune?

Pranimi i dhunës si një normë nxit një kulturë diskriminuese dhe armiqësore, ku dhuna është një rekurs i nderuar apo i arsyeshëm. Edhe komuniteti aktivist nuk ka qenë imun ndaj adoptimit të gjuhës së dhunës: sa vite e kemi degjuar titullin: nevoja për të 'luftuar' DHBGJ?

Si shoqëri, si individë, ne duhet të përballemi me pikëpamjen që ekziston shpesh se dhuna ose kërcënimi i dhunës shpesh është i dobishëm, një mjet për të arritur qëllimin. Kjo mbështet dhe përforcon pabarazitë e vazhdueshme dhe diskriminimin në të gjitha nivelet e shoqërisë. Këto pabarazi nisin dhe janë të bazuara në pushtet, por shfaqen përkrah cështjeve të gjinisë, të ardhurave, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike, dhe moshës. Dinamikat sociale si rrjedhim, prodhojë rezultate anomike dhe të dëmshme - si nga burrat ndaj grave, por edhe ndaj burrave të tjerë.

Njerëzit vulnerabël janë më të rrezikuar dhe vuajnë rreziqet e ndikimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të këtyre normave. Në Shqipëri, ende, ky grup janë gratë, vajzat dhe fëmijët në veçanti, të cilët përjetojnë nivele të larta dhe forma të shumta të ofendimit, dhunës dhe abuzimit.

Modelet dhe ciklet e dhunës formohen lehtë, të rrënjosura në normat dhe qëndrimet shoqërore e familjare. Formimi i qëndrimeve bën që normat gjinore të transmetohen ndër gjenerata. Në vitin 2013 ky studim gjeti, por dhe studime ndërkombëtare kanë konfirmuar, se ata djem dhe burra që si fëmijë kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje kanë më shumë gjasa që të kenë pikëpamje jo të favorshme për barazinë gjinore dhe janë të përgatitur për të përdorur dhunë.

Pabarazia gjinore është gjithashtu reflektuese: influencon dhe është infuencuar nga faktorë strukturorë dhe individual. Pra, institucionet kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe nxitjen e përgjigjeve të duhura, pasi mund të ndikojnë të gjitha nivelet e shoqërisë ku manifestohen pabarazitë: tek individi, familja, komuniteti dhe publiku i gjerë. Në të vërtetë, është e qartë se ndryshimi nuk do të vijë pa ndërhyrje të planifikuar mirë.

Ky projekt është themeluar mbi një kuadër konceptual, me një vizion për një afat më të gjatë, për angazhimin e djemve dhe burrave. Thelbi i tij është studimi mbi qëndrimet aktuale të të rinjve, normat mbizotëruese dhe realitetet e marrëdhënieve gjinore mes kolegëve, anëtarëve në familje, komunitet dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

Në qendër të studimit, pra, është një eksplorim i çështjeve kryesore që prekin gratë dhe vajzat në Shqipëri, kryesisht përmes perspektivave të djemve të rinj dhe burrave. Temat qendrore përfshijnë qëndrimet ndaj dhunës, të drejtat dhe barazinë. Ne ishim gjithashtu të vëmendshëm ndaj pasojave dhe ndërveprimit të këtyre çështjeve me arsimin, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat (SRHR), prezantimet gjinore në mediat tradicionale dhe ato të reja, barazia gjinore, pabarazitë socio-ekonomike dhe vulnerabilitete të tjera.

Studimi i parë FjalëBurri tregoi rezultate inkurajuese. Ai e bëri të qartë se ndërhyrjet e hershme tek të rinjtë mund të ndihmojnë për të kuptuar pse vijojnë pabarazitë, diskriminimi dhe dhuna nëpër gjenerata.

Një qasje edukative ofron një mundësi të jashtëzakonshme për të kuptuar si formohet qëndrimi dhe sjellja e të rinjve. Shpresojmë që njohuritë e fituara nga "normat" shqiptare të jenë të dobishme për institucionet dhe aktorët e angazhuar në parandalimin dhe programet në këtë fushë.

# DHBGJ NE SHQIPERI

## NIVELET E DHUNËS

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet problem në të gjitha shtresat shoqërore në Shqipëri.

Megjithatë, për një sërë arsyesh të dukshme, dhuna është nën-raportuar dhe problemi i vërtetë është disi më i madh se sa të dhënat zyrtare mund të tregojnë. 3967 raste të dhunës në familje u raportuan ne vitin 2015, dhe nivele të ngjashme janë regjistruar në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, me 2052 raste dhe 877 kërkesa për urdhër të mbrojtjes civile (PSh, 2016). Nga këto, shumica e femrave (74%, ose 1505 në total) janë dëmtuar fizikisht.

Femrat kanë më shumë gjasa të jenë viktima të dhunës në familje. Megjithatë si vajzat ashtu dhe djemtë mund të përballen me ekspozimin ndaj dhunës në familje, qoftë drejtpërdrejt ose si dëshmitarë, si psh në gjysmën e parë të vitit 2016 ku111 fëmijë u demtuan fizikisht (ibid.).

## GJINIA

Si kanë ndikuar ndryshimet globale dhe ato ndër breza në vlerat dhe qëndrimet e shoqërisë shqiptare? Ku kanë ndikuar në aspektin e marrëdhënieve gjinore? Ka përjetuar Shqipëria ndryshime transformuese sociale si ato në sferën politike dhe ekonomike?

Gjithnjë e më shumë, djemtë dhe vajzat janë duke vënë në pyetje rolet tradicionale gjinore. Shumë faktorë pozitive gjenden pas kësaj, duke përfshirë emancipimin e grave dhe rritjen e mobilitetit social. Megjithatë, rritja e vetëdijes së normave të dëmshme gjinore, dhe fushata pozitive për çështjet gjinore kanë motivuar gjithashtu një dëshirë për ndryshim. Iniciativat që kanë për qëllim vendosjen e lirive dhe të drejtave arrihen jo vetëm si ide, por modele të reja zgjedhje identiteti, mënyre jetese, preferenca dhe marrëdhënie shoqërore e seksuale. Në formimin e identiteteve të tyre, të rinjtë ndikohen prej mjedisit ku jetojnë.

Kjo përcaktohet kryesisht nga faktorë strukturorë në procesin e socializimit që në fund të fundit varet nga miratimi i bashkëmoshatarëve. Megjithatë, në Shqipëri ka veçanërisht ndikim të fortë familja dhe media ndër të tjera. Këto janë kryesore në zhvillimin e qëndrimeve dhe besimeve në lidhje me rolet gjinore dhe barazinë. Barazia gjinore është tregues dhe mundësues i zhvillimit

shoqëror, një bazë e rëndësishme e familjes dhe jetës në komunitet.

Pabarazia shoqërohet gjithmonë me status të reduktuar në fuqi, dhe me përjashtim. Studime ndërkombëtare tregojne se njerëzit me qëndrime pro barazise gjinore raportojnë se janë "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" me marrëdhëniet e tyre në çdo nivel, duke përfshirë dhe ato seksuale.

Për djemtë, sa më vetëdijshëm për modelet e barazisë gjinore dhe të drejtat aq me shumë shanse kanë të ruajne marrëdhënie të suksesshme. Normat gjinore zakonisht reduktojnë pavarësine e vajzave dhe grave për të shprehur dëshirat seksuale, ndërsa njëkohësisht dhe pse paradoksale, nxisin lirinë seksuale dhe mos frikën nga rreziku për djemtë.

Media po ashtu projekton qëndrime moralizuese ndërsa mbetet kundër diversitetit dhe praparojë në portretizimin e stereotipeve femërore dhe imazhit të ashpër të mashkullit. Grupmosha e re nxjerr konkluzionet e saj nga mesazhet e shumta që ju jepen, por nga studimi i parë FjalëBurri ne gjetëm se këto mund të paraqesin dekurajim të thellë, madje shpesh frenues ndaj identiteteve te ndryshme dhe normave mbi mardhënjet.

Dhuna gjinore është kryer përkrah pushtetit ekonomik dhe social. Ndaj, për të reduktuar ose eliminuar dhunën, është me rëndësi të arrihet barazia gjinore, të rritet statusi i grave dhe të drejtat si në praktikë ashtu edhe në legjislacion.

Angazhimi i burrave dhe djemve është i domosdoshëm, për të arritur një shoqëri me tolerancë të vërtetë ndaj diversitetit dhe ndryshimit.

## ARSIMI

Përmirësimi i arritjeve arsimore të vajzave është thelbësore në arritjen e barazisë gjinore. Vajzat që kanë qasje në arsim kanë më pak të ngjarë të përjetojnë dhunë në marrëdhënie. Ato janë edhe më të informuara dhe në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre.

Aftësimi i vajzave për të kërkuar të drejtat e tyre në shëndetin seksual dhe riprodhues dhe në familje paraqet sfidë dhe është një kontekst tërësisht ndryshe nga rritja e aksesit në mundësitë ekonomike dhe politike. Megjithatë, vetëdija mbi të drejtat që vjen nga kjo e fundit ofron një platformë të madhe për avancimin e aksesit ne mundësitë ekonomike.

Si rrjedhim, arsimimi i fokusuar mbi të drejtat dhe barazine është i rëndësishëm për reduktimin e rreziqeve dhe praktikave të dëmshme për gratë. Po kështu, studimet mbi djemtë dhe burrat kanë treguar se arsimi mund të sjellë përfitime të mëdha për jetën e tyre dhe jetën e partnereve të tyre femra si dhe në familje.

Djemte janë bërë të ndjehen se nevoja për ndihmë, arritja akademike apo shprehje të ndryshme seksuale në shkollë nuk janë karakteristika mashkullore. Gjithashtu, ata shpesh përballen me presionin për ta braktisur shkollën për të fituar të ardhura për të mbështetur familjen, dhe u mungon një shumëllojshmëri modelesh meshkuj në klasë.

Prandaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përvojës së djemve dhe vajzave në mjediset arsimore. Ka mjaftueshem studime ndërkombetare që tregojnë se dhuna me bazë gjinore në shkolla, përvojat e dhunës seksuale, abuzimi, dhe ngacmimet në shkollë mbeten të paraportuara dhe të pa dokumentuara.

Edhe pse ka pak studime për këtë në Shqipëri, ne vështirë se mund të presim që situata këtu të jete ndryshe. Megjithatë, të kuptuarit e marrëdhënieve në këto mosha formuese është jetik për çdo përpjekje që synon të angazhoje djemtë ndaj DHBGJ.

# SKICA E KËRKIMIT

Miratimi i Planit Kombëtar (PK) siguron themelin për angazhimin e burrave dhe djemve për ta bërë dhunën me bazë gjinore shoqërisht të papranueshme. Veprimet e rekomanduara në të përfshijnë gjetje zgjidhjeje për nevojat e autorëve të dhunës në familje dhe burrave, si dhe për të kryer një studim mbarëkombëtar për burrat dhe dhunën në Shqipëri.
Studimi FjalëBurri i shtohet njohurive aktuale dhe të bazohet në këto rekomandime për:

## I. STUDIMI MBI QËNDRIMET DHE BESIMET

Përgjigjet subjektive nga burra, djem, gra dhe vajza mbi qëndrimet ndaj dhunës u mblodhën përmes hulumtimeve empirike. Kjo ishte në formën e një pyetësori të bazuar në shkallën e barazise gjinore per burra GEM (PROMUNDO: www.promundo.org.br) i cili u përshtat për kulturën dhe kontekstin shqiptar si dhe për të evidentuar të dhëna shtesë e lehtësuar profilin e qëndrimit.

## II. PUNËTORITE ME KOMUNITETIN

Aktivitetet u përqendruan në punëtori me shumicë pjesëmarrësish burra e djem. Tema dhe aktivitetet e punëtorisë ishin projektuar për të shqyrtuar dhe të eksploruar ndërgjegjësimin, qëndrimet dhe çështjet rreth gjinisë dhe DHBGJ. Bazuar në parimet e hulumtimit me pjesemarrje, punëtoritë angazhuan dhe zbatuan teknika loje ku pjesëmarrësit u inkurajuan të udhëheqin investigimin në një mjedis të sigurt dhe në një strukturë konceptuale te mirëmenduar.

## SHËNIM

Studimi është hulumtim formues që shqyrton interesat, atributet dhe nevojat e grupeve dhe individëve në komunitet. Eshtë projektuar si i tillë për të identifikuar dhe kuptuar situatën lokale, brenda kontekstit kombëtar. Të dhenat mund të ushqejnë hartimin e nismave në përgjigje të nevojave lokale, që janë vendimtare për kauzën dhe aktivizmin në të ardhmen.

Studimi zhvillohet në periudhë kohe të limituar, ndaj ne jemi të vëmendshëm kur bëjmë krahasime me studimin e kaluar. Kufijtë e vlefshmërisë së gjetjeve vijnë nga natyra e lokalizuar e këtij hulumtimi. Ndryshimet rajonale mbeten disi të panjohura. Megjithatë, parimi i "përgjithësimeve' na lejon të pohojmë se gjetjet kanë një nivel vlefshmërie për të gjithë publikun e gjerë. Kjo sidomos pasi rajonet nën studim nuk janë zona jo-tipike socio-ekonomike. Kështu, pyetësori nuk synon të kapë të dhënat socio-ekonomike dhe kjo është supozuar e pandryshueshme për zonat në studim. Ne pranojmë megjithatë që të dy zonat refletojne lidhje ekzistuese të rrjeteve sociale, qoftë në Dibër për shkak të rregullave të Kanunit e trashëgimisë së tokës apo në Durrës me familjet e zgjeruara migratore, kresisht veriore, dhe të vendosura në afërsi të njëra-tjetrës.

Angazhimi i pjesëmarrësve ishte vetë-përzgjedhës në të gjitha fazat, si rrjedhim mungoi kampioni i rastësishëm. Në këtë aspekt vjen në ndihmë qëllimi i projektit, i cili ishte për të identifikuar grupet e individëve meshkuj të cilët do të mbështen në rolin e liderit për të sjellë ndryshim. Rezultatet e seminarit janë dokumentuar në mënyrë informale dhe vlerësuar kundrejt grupeve të kontrollit apo të aktiviteteve sistematike para dhe pas. Prandaj, potenciali i dyzimeve sociale dhe ndikimi në angazhim nuk janë marrë në konsideratë.

# PROJEKTIMI I STUDIMIT

Thelbi i projektit FjalëBurri është një qasje e përzier metodash e kombinuar dy instrumente kryesore për:

- Rezultate sasiore: Një studim sasior mbi qëndrimet dhe rolet gjinore
- Rezultate cilësore: Shkolla dhe punëtori të komunitetit

Keto dy qasje mundësojnë që rezultatet e anketimit  të shërbejne si bazë per aktivitetet në punëtori. Konteksti i anketës rezulton pranë me shqetësimet e jetës reale, paraqet projektin në nivel lokal dhe inkurajon liderët e komunitetit të angazhohen me projektin që në fillim.

## GRUPET E STUDIMIT DHE ZONAT

Zonat e anketës ishin të njëjta me studimin e parë, Durrës dhe Dibër, megjithëse kësaj here më i shtrirë në terren. Këto zona u zgjodhën fillimisht si përfaqësuese të konteksteve të kundërta, për të arritur një përzierje të zonave urbane dhe rurale. Anketa është ideuar kryesisht të përqëndrohet tek djemtë adoleshentë të moshës 14-19. Ne gjithashtu përfshimë qëndrimet e prindërve dhe vajzave përmes një formati shtesë me pyetje të gjysmë-strukturuara. Kjo ndihmon për të mbledhur të dhëna mbi qëndrimet e meshkujve, fëmijëve dhe të rriturve mbi rolet gjinore. Për të reduktuar dekurajimin dhe numrin e pyetësorëve të pavlefshëm, u përzgjodhën pyetje që të kërkojnë rreth 20-45 minuta për tu plotësuar në total. Kampioni në të dy zonat ishte në nivel të përafert, me ndryshime të vogla për të reflektuar demografitë e ndryshme - psh. Durrësi më i populluar se Dibra. Një shumëllojshmëri instrumentash kërkimore u përdoren për të zbutur këtë efekt, duke përfshirë optimizimin e sipërfaqes së përgjigjes për të shmangur paragjykimet numerike në analizë. Brenda çdo zone, u përdorën metodat e kampionimit të rastësishëm që sigurojnë përfshirje të mjaftueshme dhe raportin e probabilitetit kundrejt madhësisë.

## MODELI I ANKETIMIT TE SHKALLES SE BARAZISE GJINORE PER BURRA (GEMS)

Si në studimin e mëparshëm në vitin 2013, pyetësori u bazua dhe u përshtat me GEMS (shkalla e barazise gjinore për burra) e zhvilluar fillimisht nga PROMUNDO. I përshtatur në punën kërkimore mbi familjen në më shumë se 20 vende, ky instrument është  i vlefshëm për të zbuluar qëndrimet në lidhje me gjininë,  dhe çështje të tjera të testuara dhe vërtetuara në qëndrimet dhe praktikat që lidhen me barazinë gjinore të njerëzve. Pyetësori është përshtatur dhe përdorur në të gjithë kontekstet - duke ruajtur grupin bazë të pyetjeve të krahasueshme - të aplikueshme dhe që kanë kuptim në cdo kulturë. Siç shihet në rezultatet e FjalëBurri 2013, GEMS ofron vlefshmëri parashikuese dhe qëndrueshmëri të fortë si instrument kërkimor. Gjetjet ndërkombëtare sugjerojnë se ka lidhje midis rezultateve të shkallës GEM dhe sjelljeve të dhunshme të burrave. Shkalla GEM arrin te evidentojë shqetësimet kryesore dhe faktorë të rëndësishëm në shkaqet që formojnë qëndrimet e dhunëshme. Shkalla GEM është veçanërisht e përshtatshme për të elaboruar normat mbizotëruese në komunitetet që po hulumtohen.

## PËRSHTATJA E STUDIMIT NË REALITETIN SHQIPTAR

Shkalla GEM "vjen nga një perspektivë sociale e ndërtimit të identitetit gjinor" (Barker 2001), ku çdo ambjent kulturor ofron një version të vetin, ose disa versione, të sjelljeve të përshtatshme për burrat dhe gratë në atë kontekst. Normat gjinore transmetohen tek djemtë dhe të rinjtë nëpërmjet familjarëve, kolegëve, ndikuesve sociale dhe ndërveprimeve. Ato përvetësohen dhe shfaqen nga individët. Ky "riprodhim" i vlerave pastaj kthehet në influencues (Baker,

2001) të normave në familje dhe komunitet.

Si i tillë, GEMS është veçanërisht i zbatueshëm për një projekt, ku çështjet dhe nevojat kërkojnë një element të zbulimit, përpunimit dhe shqyrtimit. I tillë është rasti në Shqipëri, ku vetëdija mbi çështjet gjinore dhe pranimi i tyre, të para nën dritën e zhvillimeve të fundit legjislative dhe fushatave për të drejtat, mbetet i ulët dhe normat gjinore mbeten pothuajse tërësisht të pamodernizuara.

Sondazhi është i zbatueshëm dhe i rëndësishëm për të studjuar grupet, i përshtatur të jetë "relevant për meshkujt e rritur në mardhënje të qëndrueshme, bashkëjetese ose dhe ata që nuk janë në një marrëdhënie të qëndrueshme; për burra që identifikojnë veten si heteroseksual, apo dhe meshkujt me orientime të ndryshme seksuale; burra që kanë fëmijë në familje (biologjike apo jo) dhe ata që nuk kanë "(Barker 2001).

## PËRSHTATJA NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

Në përshtatjen e instrumentit GEMS në studim tonë për nevojat dhe kontekstin shqiptar, kemi bërë disa ndryshime të qasjes. Këto mund të kufizojne riprodhueshmërinë dhe krahasueshmërinë e hulumtimit me gjetje jashtë kontekstit shqiptar, por na lejon të kemi nje ide të përgjithëshme mbi realitetin në vend. Studimi mundëson krahasim të çështjeve pa elaborime konceptuale.

Ne thjesht nuk mund të supozonim se të anketuarit ishin në dijeni të çështjeve gjinore. Këtu, ishte me rëndësi të veçantë të shmangeshin paragjykimet dhe influencimi i mendimit. Për këtë arsye është e rëndësishme që qëllimet dhe vlerat e studimit nuk ju imponuan audiencës. Pra pyetjet duhej të formuloheshin dhe paraqiteshin në mënyrë neutrale dhe të shmangej paragjykimi.

Vëmendje e veçantë ju dha fjalorit dhe gramatikës, dhe radhës së prezantimit të çështjeve sa i përket përsëritjes së pyetjeve. Integriteti i studimit qëndron në aftësinë për të kapur 'përgjigjen e vërtetë "dhe jo" atë që ata duan të dëgjojnë ". Vëmendje e veçantë ju dha ruajtjes së anonimitetit për të siguruar që ne të kishin më shumë gjasa për të marrë një përgjigje përfaqësuese.

Përtej instrumentit GEMS ne zhvilluam edhe pyetjet tona mbi mënyrat e jetesës dhe rolet

gjinore. Kjo sigurisht kërkoi një dizajn dhe informacion paraprak në lidhje me këtë çështje dhe atributet e saj. Ne i zgjodhëm çeshtjet në varësi të strukturës së pyetjeve të grupuara dyshe ose treshe. Të anketuarit tregojnë profilin e preferuar në cdo grupim.

## VLERËSIMI INSTRUMENTIT

Sondazhi u testua për shkallën e mbulimit në aspektin e madhësisë së kampionit, fuqinë, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e brendshme (duke përdorur Cronbach Alpha), vlerësimin e efiçencës se parametrave, korrelacioni ndërmjet efekteve dhe vlefshmëria parashikuese. Teoria e përgjigjes sipas artikujve është përdorur për rezultatin e testit, duke lejuar për analizë të rezultateve si nga subjekti dhe artikulli. Kjo na jep informacion për në çdo kontribut sipas temës. Gjithashtu pasuron instrumentin e kërkimit në zbulimin e tipareve të fshehura (modelet Rasch).

## ANALIZA

Përgatitja e të dhënave: përgjigjet e pyetësorëve u dokumentuan dhe grupuan para analizës. Modelimi i të dhënave dhe para-përpunimi u krye si fillim, kryesisht për pastrimin e të dhënave dhe identifikimin e vlerave që mungonin. Para-analiza e përgjigjeve mundësoi kryerjen e testeve për të gjitha përgjigjet e kombinuara. Vlefshmëria e rezultatit u testua duke shqyrtuar ndryshimet në përgjigje sipas shkallës GEM dhe që përgjigjet të kishin kuptim në çdo kontekst social, nga ato me shkallë barazie gjinore më të lartë tek ato më të ulëta. Ky ndryshim në përgjigje tregon se kjo metodë e detajuar është e suksesëshme në kapjen e dallimeve dhe se të anketuarit nuk janë duke dhënë thjesht përgjigje të gatëshme.

Statistika përshkruese janë përdorur për të analizuar dhe interpretuar të dhënat treshe. Kjo përfshinte analizën e frekuencave, teknikat multivariate për të dhëna kategorike duke përdorur masën Spearmans Rho për korrelacionin. Regresioni logjistik binar u krye për të parashikuar mundësinë e përgjigjeve të dëshiruara, dhe për të përcaktuar se cilat variabla janë të lidhur më ngushtë me këto rezultate, me anë të vlerave-p; raportet e rastësishme dhe grafiket. Analiza parashikuese, CHAID dhe teknika të thjeshta të të mësuarit automatik u përdorën për të zhvilluar modele të shoqërizimit dhe besimit. Analiza cilësore dhe tekstuale u përdor për të interpretuar pyetjet e hapura.

# STUDIMI ME PJESËMARRJE

## PUNËTORITË ME KOMUNITETIN

Hulumtimi cilësor u përqëndrua në disa punëtori me ftesë të hapur për komunitetin, të cilat ishin

• Punëtori arsimore ku u përfshinë djem dhe vajza në mjedis shkollor.
• Punëtori komunitare që përfshijnë kryesisht djem dhe burra nga komuniteti i gjerë.

Këto përmbushën disa qëllime si psh, ofruan një platformë të sigurtë për eksplorimin çështje dhe zërit në komunitet; krijuan një kontekst të vlefshëm për kuptimin e gjetjeve sasiore që dolën nga anketa. Komunitetet e Dibres përfshinë Brest i Poshtëm, Brest i Sipërm, Kukaj, Pergjegje, Kander, Kishavec, Sohodoll, Peshkopi. Komunitetet Durrës përfshinë Spitallë dhe Porto Romano.

Gjetjet nga pyetësori kontribuan në formatin e punëtorive, i cili fillimisht shqyrtoi nivelet e vetëdijes dhe të kuptuarit e normave dhe të roleve gjinore, si dhe DHBGJ në Shqipëri dhe së dyti angazhoi pjesëmarresit të diskutojnë mbi çështjet e marrëdhënieve gjinore, dhunën ndaj grave si dhe të eksplorojnë se si të sjellin ndryshim në nivel lokal. Temat përfshinë:

• Eksplorimi i mënyrave si formohet qëndrimi: Zbulimi i fakteve, shkaqet dhe motivet. Mënyrat në të cilat ne kushtëzohemi nga mjedisi shoqëror dhe kulturor u hulumtuan përmes lojërave dhe sfidave. Duke treguar se shpesh ne jemi të kufizuar në ato "ato që na kanë mësuar", u dhanë shembuj që reflektonin ngurrimin për të dalë hapur kur nuk ndihemi të sigurt për diçka dhe frika e të qënit "të gabuar".

• Për të kuptuar ndikimin u analizuan bindjet, marrëdhëniet shoqërore dhe pengesat për të ndryshuar. Tek kush kemi ndikim? Kush na ndikon? A kemi modele? Si mund të kapërcejmë dallimet që komplikojnë marrëdhëniet? Si mund të krijojmë respekt të ndërsjelltë? Aktivitetet hetuan vështirësite e motivimit dhe vunë theksin në punën për një qëllim të përbashkët.

• Hedhja e ideve: Zhvillimi i ideve për të penguar dhe ndaluar DHBGJ, përmirësimin e marrëdhënieve gjinore në shtëpi dhe komunitet, duke përfshirë perspektivat meshkuj dhe femra në fushata.

• Mundësimi i ndryshimit: Ngritja e zërit: ku do të pozicionohemi në procesin e ndalimit të dhunës? A ndyshoi perspektiva juaj pas këtyre punëtorive? Cfare ka ndryshuar për ty? Po tani? Si mund të arrijmë ndryshimin? Si të gjejme mbështetje nga institucionet vendore dhe në komunitet; të identifikojmë udhëheqësit; të nxisim ndryshime dhe të marrim një rol aktiv.

Së fundi, "Fjalëburri 'do të thotë: Burri lidhet prej fjalës. A mund ta japësh fjalën tënde sot?

# PJESËMARRJA

Pjesëmarrja efektive varet nga krijimi i një ambienti të sigurt në të cilin mund te bëhet diskutimi i lirë, i drejtë dhe i sinqertë. Kjo u arrit duke krijuar një axhendë të qartë dhe objektiva për punëtoritë, vendosje të kufijve dhe rregulla të angazhimit për pjesëmarrësit që në fillim të seancave.

Në këtë kuadër, pjesëmarrësve ju dha hapësirë e pakufizuar për të marrë drejtimin në diskutime dhe aktivitete, me ndihmën e dy lehtësuesve në çdo punëtori. Pyetësorët dhe organizimi punëtorive u koordinuan në bashkëpunim me partnerët e komuniteteve lokale.

Ishin 87 pjesëmarrës në katër punëtori në të dy zonat. Punëtoria komunitare tërhoqi pjesëmarrje të ndryshme nga komunitetet, duke përfshirë pushtetin vendor, shoqërinë civile dhe prindër të fëmijëve të shkollave ku u realizuan pyetësoret. Kjo krijoi një dinamikë interesante në rastet kur ishin prezent të dy prindërit dhe fëmijet, ose kur të dy bashkëshortët ndoqen të njëjtën punëtori. Dinamikat e reja u pasqyruan duke sjelle dhe krahasime interesante me studimin e mëparshëm, sidomos për sa i përket familjeve të zgjeruara, tolerancën brezave dhe rolin e Kanunit në sistemin e vlerave.

Hulumtimi me pjesëmarrje
Të dy zonat pilot të Dibrës dhe Durrësit u përzgjodhën për studim, për të zbuluar dallimet që mund të ekzistojnë gjeografikisht në drejtim të qëndrimeve dhe angazhimit me çështjet kundër DHBGJ. Kontraste të tilla mund të përdoren për të pasuruar dhe bërë me relevante për komunitetin fushatat kombëtare.

**TE ANKETUARIT NE DIBER**




**TE ANKETUARIT NE DURRES**




**PYETËSORËT**

**182 burra, 119 djem dhe 150 vajza plotësuan pyetësorët. Gjinia ishte me vetë raportim. 46 të anketuar nuk raportuan gjininë e tyre. Pyetësoret me të dhëna të jo të plota nuk u numëruan për këtë studim, kështu që pyetësorët nga Dibra ku nuk kishte të dhëna te sakta nuk u përfshin ë në analizë.**

**Shkollat që morrën pjesë ishin Sllovë, Kastriot dhe Gjimnazi Seit Najdeni qytetin e Peshkopisë.**

**541 burra, 221 djem dhe 158 vajza plotësuan pyetësorët. Gjinia u vetë raportua.**

**Shkollat që morrën pjesë ishin Naim Frasheri, Gjergj Kastrioti, Neim Babamento dhe Met Hasa.**

# NË INTERNET

Si pjesë e studimit u zhvillua dhe nje fushatë organike në internet nëpërmjet një aplikacioni, faqe interneti dhe faqe Facebook. Kjo na dha mundësi për të arritur një audiencë kombëtare me mesazhet e fushatës dhe për t'u angazhuar me diasporën shqiptare.

Fushata ishte kunder DHBGJ, duke përdorur mesazhet globale të fushatës por edhe me një mesazh specifik shqiptar me gjetje nga studimi i vitit 2013, sic ilustrohet ne faqen 21.

Ne i kërkuam audiencës të tregojë qëndrimet e tyre përmes pëlqimit apo ndarjes së mesazheve në rrjetet e tyre sociale. Kjo mundësoi vlerësimin e nivelit të angazhimit me materialet kunder DHBGj.

Analiza e rrjetit social mundësoi kristalizimin e një profili, të kuptuarit si mund të rritet audienca në internet (ne numër) dhe në ndikim (ndarja e informacionit), duke përfshirë këtu dhe në nivel lokal, ku pjesëmarrësit e seminareve u angazhuan edhe online.

## Webfaqja
## www.fjaleburri.net

**Vizitorë:**
Shqipëri (90%), Zvicër, Itali, SHBA, Gjermani.

**Qyteti:**
Tiranë 59%, Durrës 20%, Vlorë 16%, Shkodër 5%

**Aktivitete**
1.1% e vizitorëve (Pëlqej/G+/tweet)

**Analiza:**
18% e përdoruesve nuk u angazhuan fare me përmbajtjen e mesazhit.

## Facebook
## 2FjaleBurri

**Audienca**
220 miq
Audienca javore: 250-1250
Miq të miqve: 36,521

**Miq të përbashkë:**
Mesatarja: 8 | më e larta: 42

**Vendet:**
Shqipëri (79%), Kosovë (12%)
Itali (7%), Zvicër, SHBA, Mbretëri e Bashkuar
Age Profiles: 16-63 Mesatarja: 32

**Profilet gjinore:**
Femra 57% | Meshkuj 43%

Facebook Meshkuj




Facebook Femra




beqar(e)
në marrëdhënie
i/e martuar

# GJETJE NGA ANKETA DHE PUNËTORITË

Për të kuptuar se pse vazhdon DHBGJ, ajo duhet të shihet në në të gjitha aspektet e kontekstit të marrëdhënieve gjinore. Dihet tashmë se normat dhe vlerat shoqërore mbartin dhe lejojne pranimin e DHBGJ. Po ashtu, rreziqet dhe rastet e dhunës me bazë gjinore janë më të larta në grupet me pasiguri sociale -ekonomike. Të dhënat nga ky studim nxjerrin dy gjetjet kryesore që kanë lidhje dhe plotësojnë njëra tjetrën:
(1) Rithekson nevojën për të vazhduar angazhimi i djemve dhe burrave, si aleatë për të arritur barazinë gjinore dhe si mbështetës për fuqizimin e grave dhe vajzave.
(2) Thekson rëndësinë e të kuptuarit dhe zgjidhjes së nevojave specifike dhe dobësitë e djemve dhe burrave në kontekstin e çështjeve të DHBGJ.

Në lidhje me këtë të fundit, çështjet e ndërvarura nga vështirësite ekonomike u përmendën si problem në punëtoritë e komunitetit. Kjo sugjeron se ne nuk mund ta analizojmë dhunën të izoluar nga çështjet e tjera. Në të vërtetë, varfëria dhe përjashtimi social luajnë një rol qendror në krijimin e vulnerabilitetit tek të rinjtë, dhe ndërveprojnë e ndikojnë në realitetet gjinore. Këto gjetje janë të ngjashme me gjetjet në studimin e vitin 2013. Ç'është më e rëndësishmja:

• Pjesa më e madhe e burrave dhe djemve, e konsiderojnë përdorimin e dhunës të justifikueshëm  në marëdhënjet e tyre.
• Ku vendoset kufiri i tolerancës varet shume nga skenari ose rrethanat ku gjendet individi.
• Rreth gjysma e meshkujve e konsiderojnë dhunën kundër grave dhe vajzave të justifikueshme për hakmarrje.
• Një pakicë e konsiderushme e vajzave (40%) gjithashtu mendojnë se dhuna ndaj grave mund të justifikohet në rast hakmarrje. 36% e vajzave ose nuk pajtohen ose nuk e di nëse është e drejtë që një burrë të ngrejë dorën kundër një gruaje.
• Pothuajse 70% e të anketuarve theksojnë se ata kanë dëgjuar, ose të paktën janë të vetëdijshëm, për politikat dhe strategjitë mbi dhunën ndaj grave.
• Edhe pse gati gjysma e njerëzve shprehin mbështetje për kuotat në rritje të pjesëmarrjes së gruas në jetën politike dhe ekonomike, kjo nuk është domosdoshmërisht e pasqyruar në pikëpamjet e tyre të shprehura në ambjentet familjare.
• Shumica e të anketuarve shprehin tolerancë të kufizuar për mendimin ndryshe, aq më pak për diversitetin e mënyrës se jetesës, dhe shumica shprehin një shkallë homofobie.
• Më shumë se 70% e burrave dhe djemve besojnë se ligji nuk i mbron mjaftueshëm viktimat e dhunës dhe dënimet janë shumë të buta. Po ky grup ka gjithashtu më shumë gjasa të shprehet përmes dhunës. Shumica e të anketuarve janë shprehur se ata ose nuk do ndërhyjnë, ose nuk janë të sigurtë nëse do të ndërhyjnë në qoftë se ata ishin dëshmitarë në një situatë DhBGj.
• Pjesa më e madhe e burrave dhe djemve (60%) besojnë se njerëzit mund të kujdesen për fëmijët po aq mirë si edhe gratë. 61% e vajzave nuk pajtohen. Si rrjedhim, ne mund të hedhim hipotezën se burrat dhe djemtë kanë koncepte të ndryshme ndaj përkujdesit  në krahasim me gratë dhe vajzat.
I njëjti kampjon burrash e djemsh gjithashtu shprehu fuqishëm qëndrime pro dhunës.

### Dhuna dhe Meshkujt

1. Pjesa më e madhe e burrave dhe djemve vazhdojnë të mendojnë se rrënjët e agresivitetit dhe dhunës lidhen me mjedisin ku jetojnë. Megjithatë, ndoshta ashpërsimi i kushteve sociale ekonomike mund të ketë ndikuar në rritjen e perceptimit të agresivitetit që vihet re tani (kundrejt 8% burra, 9% djem në 2013).

2. Burrat deklarojnë një prirje më të lartë për të përdorur dhunën (kundrejt 39% burra, 46% djem në 2013).

3. Burrat shprehin një nevojë më të madhe për respekt (54% burra dhe 46% djem në 2013). Punëtoritë hulumtuan lidhjen mes kësaj nevoje dhe shqetësimeve ekonomike.

4. Nevoja për respekt në mbjentin familjar është ende thlebësor për meshkut. Megjithatë, qëndrimet e djemve mund të ndryshohen (82% burra, 84% djem ne 2013).







### Barazia gjinore

5. Punëtoritë zbuluan një ashpërsim të qëndrimeve ndaj bashkëveprimit të jetës publike dhe private të cilat mund të shpjegojne këto të dhëna (35% meshkuj, 26% djem në 2013 ).

6. Qëndrimet e pabarabarta ndaj pavarësisë së grave në martesë vijojne (35% meshkuj, 28% djem në 2013).

7. Një pakicë e konsiderueshme mendojnë se gratë duhet ta tolerojnë dhunën në vend (45% burrat dhe 31% djem më parë).

8. Burrat shprehin gjasa shumë më të ulëta për të ndërhyrë sesa djemtë, madje me një trend dukshëm në rënie edhe në krahasim me studimin e mëparshëm (75% burra, 76% djem në 2013). Ky konstatim duhet sigurisht të analizohet në detaje sipas formave të dhunës dhe sjelljet e burrave në ambjentet familjare e publike dhe të djemve në ambjentet shkollore.

# REZULTATET E ANKETIMIT




P1. Eshtë e natyrshme për burrin të veprojë në mënyrë agresive

P2. Ndonjëherë të goditurit është e vetmja mënyrë për të shprehur ndjenjat

P3. Burri që nuk lufton kur e nënvleftësojnë humbet respektin si burrë

P4. Dhuna ndodh edhe pa dëmtime fizike

P5. Duhet ruajtur durimi gjatë një sherri




P6. Burri mund të kujdeset për fëmijët po aq mirë sa dhe gruaja

P7. Burri duhet ta thotë fjalën e fundit për vendimet në familje

P8. Nëse më fyejne, do ta mbroj reputacionin tim edhe me dhunë po qe nevoja

P9. Gruaja duhet ta tolerojë dhunën për të mbajtur familjen të bashkuar

P10. Nëse sheh një burrë që godet një grua duhet ta ndalosh

**Të dhënat e anketës tregojnë përputhje mes pyetjeve të anketës GEMS dhe përgjigjeve të dhëna nga burrat, djemtë dhe vajzat në të dyja zonat në Dibër dhe Durrës.**

**Gjetje të rëndësishme dalin kryesisht në lidhje me uljen e preceptimit të aftësive të meshkujve për përkujdesjes ndaj fëmijëve (P6); niveli i ulët i gjasave për të ndërhyrë në një episod DHBGJ (P10) dhe qëndrimet e vazhdueshme të pabarabarta gjinore në të gjitha grupet (P15- P25). Këto janë diskutuar më tej në këtë raport.**




P11. Burri meriton gjithmonë respektin e gruas dhe fëmijëve të tij

P12. Burri ka nevojë për respekt mbi të gjitha

P13. Si burri trajton gruan është punë për të

P14. Burri nuk duhet të ngrejë kurrë dorë ndaj gruas

P15. Partnerët në një marrëdhënie duhet të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt




P16. Burri dhe gruaja duhet të jenë të barabartë në familje

P17. Secili partner duhet të ndjehet i lirë të dalë me shoqërinë e vet

P18. Në një mardhënje intime është e drejtë të godasësh, nëse je goditur

P19. Secili partner duhet të jetë i lirë të veshë ç'të dojë

P20. Kur burri dhe gruaja martohen, gruaja bëhet pronë e burrit




P21. Burri dhe gruaja duhet ti ndajnë përgjegjësitë për drejtimin e shtëpisë

P22. Eshtë detyrë e gruas, që për të mbajtur familjen të qëndrojë edhe kur ka dhunë

P23. Mamaja dhe babai duhet të kenë njësoj përgjegjësi për rritjen e fëmijës

P24. Duhet ruajtur tradita ku burri është kreu i familjes

P25. Burri duhet të vendosë në lidhje me të ardhurat e familjes

Burrat Djemtë Vajzat

# PUNËTORITË
## DIBËR & DURRËS



"NUK DUHET TE NDERHYJME NE PUNET E TE TJEREVE"

"SHKAKU I DHUNES? NJERIU ESHTE KHYER KUNDER VETES, NGA VARFERIA E DESHPERIMI"

"DHUNA NDODH KUR T'HUMB ARSYEJA.."

"ESHTE VESHTIRE ME GJET LIDERA NE KOMUNITETE TE PAPUNESH"

"DHUNA POSHTERON DHE BURRIN"



"BURRI NUK DUHET TE NGREJE DORE NDAJ GRUAS NE SY TE FEMIJEVE..."

"DHUNA DUHET ME U PERDOR NGANJEHERE"



"TALLJA ESHTE DHUNE"

## NDRYSHIMET NDËR GRUPE: GJINIA

Ka një shkallë të lartë mospërputhjeje mendimesh mbi çështjet e dhunës dhe stausit të grave. Rreth 60% e burrave dhe 50% e djemve mbrojnë përdorimin e dhunës për hakmarrje ndaj grave. Ky qëndrim ndahej dhe nga ata që u shprehën kunder ngritjes së dorës ndaj gruas. Shumë nga ata që kishin qëndrime tolerante ndaj dhunës, justifikojnë dhunën si mekanizëm për të ndërhyrë në një situatë DhBGj. Statusi mbetet me rëndësi jetike për njerëzit, por edhe për djemtë, si në komunitet, në mesin e kolegëve apo edhe në familje. Përkundër shumicës që mendojnë burrat nuk janë agresive nga natyra, pothuajse gjysma e burrave dhe djemve u shpreh se burrat shpesh kanë nevojë të luftojnë për ta ruajtur respektin apo statusin e tyre. Në punëtori, u eksplorua origjina e agresivitetit dhe dhunës. Doli në pah besimi se dhuna është mjet i domosdoshëm për të mbijetuar. Kjo mund të shpjegojë ashpërsimin e qëndrimeve që doli nga rezultatet e anketimit, me rritje te ndjeshme në numrin e atyre që e konsiderojnë dhunën të natyrshme për meshkujt (nga 14 në 17% për burrat, nga 7 deri në 11% për djemtë).Një përqindje e konsiderueshme e djemve dhe burrave kishin pikëpamje të pabarabarta gjinore. Pjesëmarrësit diskutuan nëse kjo pikëpamje vjen për shkak se gratë 'janë' më pak të vlefshme. Burrat dhe djemtë besojnë se ky është rezultat i mjedisit ku jetojnë, që nga fakti se gratë kanë nevojë për mbrojtje, roli i tyre si kujdestare, si dhe pozita e tyre në shoqëri me shprehje, si psh. gratë duhet t'ja lënë burrave marrjen e vendimeve apo gruaja bëhet pronë e një burrit pas martese (1/4 e djemve).

## NDRYSHIMET NDËR GRUPE: VENDNDODHJA

Vihen re dallime të ngjashme gjeografike në qëndrimet ndaj DHBGJ në të dy studimet: qëndrimet tolerante ndaj dhunës rezultuan te përhapura (në këtë studim të paktën) në Durrës. Ndërsa në Dibër ndonëse disi më tolerantë, nën ligjin e fortë kanunor, u vu re një dallim i fortë gjinor në mënyrën se si prona familjare vijon të trashëgohet vetëm nga djemtë ndërsa vajzat konsiderohen pronë e dikujt tjetër.

Si e tillë, dhuna bëhet një çështje me dy standarde. Gjetjet sugjerojnë se qasjet me karakter gjeografik mund të jenë më të suksesëshme. Lidhja direkte mes qëndrimeve dhunë-mbështetëse, besimeve në lidhje me barazinë gjinore dhe marrëdhënieve gjinoreu evidentua përsëri. Ndryshimet rajonale mes grupeve tregojnë disa dallime të rëndësishme të sjelljes, megjithëse këto ishin më shumë në numër sesa në lloj. Ka më shumë ngjashmëri në përgjigjet e sondazhit mes grupmoshave në Dibër se në Durrës, ku vihet re më shumë kohezion vlerash. 70% e gjithë grupeve në Durrës i konsiderojnë burrat po aq të aftë sa dhe gratë në përkujdesin e fëmijëve, ndërsa vetëm 35% e të anketuarve në Dibër e kanë këtë mendim.

Modelet e përkujdesit për fëmijë konceptohen ndryshe në varësi të zonës, ndersa mirëqenia materjale është në fokus pothuaj në mënyrë ekskluzive. Kjo mund të lidhet me punën e meshkujve. Në zonat rurale burrat punojnë në tokën e tyre (edhe pse shrehja "burrat nën hije lozin kuvendojnë" tregon se punën e bëjnë gratë), pra ata largohen nga roli i përkujdesit për fëmijë që tradicionalisht lidhet me gratë. Ndërsa në zonat urbane, papunësia i ka orinetuar njerëzit në riorganizim të rolit dhe pozitës se tyre në shtëpi, duke u angazhuhuar me fëmijët nëse lind nevoja. "Për hir të familjes, ne do bëhemi dhe gra".







**Krahasimi i përgjigjeve pranuese mes djemve dhe burrave në Durrësi dhe Dibër.**

P1 - Është e drejtë të hakmerresh kur provokohesh
P2 - Burri që nuk lufton kur nënvleftësohet është i dobët
P3 - Partnerët kanë përgjegjësi të barabarta në familje
P4 - Burri duhet të ketë fjalën e fundit
P5 - Duhet ndërhyrë në një situatë DHBGJ
P6 - Burri nuk duhet të ngrejë dorën në kundër gruas
P7 - Gruaja duhet ta tolerojë dhunën për hir të familjes
P8 - Gruaja është pronë e burrit

**Të dhënat e studimit 2013 në blu, dhe 2016 në portokalli.**






# TEMAT

**Në përgjithësi, të dhënat në 2016 tregojnë një polarizim në strukturën e besimit dhe tolerancën ndaj dhunës kundrejt studimit në 2013.**

Djemtë dhe burrat në Dibër kanë më pak gjasa ta tolerojnë dhunën apo justifikojnë DHBGJ, por kanë pikëpamje më tradicionale dhe të ngurta të roleve të gruas. Meshkujt në Durrës justifikojnë qëndrimet agresive, por janë më të tolerantë ndaj pavarësisë së gruas. Ekziston një korrelacioni i lartë në qëndrimet e burrave dhe djemve në Dibër, duke treguar një transmetim më të lartë të vlerave përmes brezave. Përgjigjet e burrave dhe djemve në Durrës ishin më të ndryshme.

Një dëshmi interesante në këtë studim kundrejt atij në 2013, ishte toleranca më e lartë ndaj grave tek meshkujt e moshuar, pra gjyshërit. Siç kanë vënë në dukje studimet e mëparshme kjo mund të jetë për shkak të një sërë faktorësh, të tilla si frika ndaj izolimit dhe rritja e varësisë për shkak të moshës së vjetër ('Të më rroje gruaja'Tahiraj, 2008), por edhe për shkak se nipërit e mbesat i bëjnë ata të reflektojne mbi ashpërsinë e rinisë së tyre. Kjo mbetet interesante për tu eksploruar më tej në lidhje me nxitjen dhe angazhimin e burrave dhe djemve.

## DHUNA

*Si e përkufizojnë dhunën burrat dhe djemtë*

Studimi Fjaleburri 2013 zbuloi se qëndrimet e djemve dhe burrave shqiptarë ndaj dhunës dhe abuzimit në familje janë komplekse, rallë janë të prera qartë dhe ndonjëherë kontradiktore. Në këtë studim të dytë, ndërsa një shumicë e të rinjve përsëri e konsideron si negative dhunën dhe abuzimin, disa lloje të dhunës dhe dhunën në rrethana të caktuara e konsiderojnë të pranueshme ose të justifikueshme. Megjithatë, është e qartë se shumica e burrave kanë standarte të ndryshme, pasi dhuna nga femrat është më pak justikueshme.

Një pjesë e madhe e burrave dhe djemve mendojnë se dhuna ndodh edhe në qoftë se nuk ka dëmtime fizike. Kjo u theksua në punëtori, se kërcënimi i dhunës dhe sjellja frikësuese gjithashtu ka po aq ndikim negativ tek viktima sa dhe dhuna fizike - "gjuha kocka s'ka por kocka thyen". Të dhënat e anketës tregojnë se faktorët socialë normative janë të lidhur me qëndrimet mbështetëse ndaj dhunës. Për shembull, mosha u shfaq si një parashikues i habitshëm ku të rinjtë kanë më shumë gjasa të mbajnë qëndrime pro dhunës se sa të anketuarit në moshë të madhe. Nga ana tjetër, brezi i ri që ka të ngjarë ta shohë dhunën si një formë të shprehjes është gati sa gjysma e burrave qe ndajnë këtë mendim (Djemtë 19%, Burrat 29%). Brenda çdo grupi kjo paraqet një rritje në krahasim me studimin e mëparshëm - rritje me 7% për djemtë dhe deri 14% për burrat.

*Toleranca ndaj dhunës*

Pjesëmarrësit e seminarit në përgjithësi nuk e konsiderojnë veten tolerantë ndaj dhunës. Gjetjet e studimit tregojnë gjendjen reale në keto komunitete, por, përpara se të trajtohen çështjet ato duhet të pranohen nga komuniteti vete, pra të ballafaqohen.

Kuptohet se ka një tolerancë më dukshme ndaj DHBGJ në pyetësorë në krahasim me diskutimet e seminarit. Në një farë mase ky është rezultat i pjesëmarrjes me vetë-përzgjedhje në punëtori, dhe natyrën ndërvepruese të punëtorisë, pasi njerëzit shqafen më konformist dhe mbajnë qëndrime pozitive kur janë në grup sesa kur shprehen anonime.

*Veprimet konkrete kundër dhunës*
Nuk duket habi që burrat të cilët nuk e mbështesin dhunën kundër grave, nuk janë të dhunshëm në përgjithësi, kanë dijeni për ligjet që ndalojnë dhunën ndaj grave dhe kanë më shumë gjasa të ndërhyjnë për të zgjidhur situata dhune. Këta janë edhe më të aftë të japin detaje të aktiviteteve që kryejnë së bashku me fëmijët e tyre dhe të shprehin qëndrime pro përkujdesjes për fëmijët. Ndërsa ata që kalojnë kohë cilësore me fëmijët ishin një pakicë, kur u dhanë shembuj (përtej thënjeve të zakonshme si "shikojmë televizor së bashku") ata u etiketuan deri diku me ironi si "prindër modernë".

## DHBGJ

Çfarë është DHBGJ? Shumica e burrave dhe djemve mendojnë se dhuna dhe abuzimi ndaj grave është i papranueshëm. Ata gjithashtu mendojnë kryesisht se burrat shkaktojnë pjesën më të madhe të DHBGJ në Shqipëri. Megjithatë, ekziston një mospërputhje këtu, pasi po ky grup shprehet se dhuna ndaj gruas mund të jetë e pranueshme në kushte të caktuara, si psh kur provokohen. Në anën tjetër, dhe në kundërshtim me faktet, një pakicë e të anketuarve mendojnë se burrat nuk janë autorët kryesorë të dhunës. Si nga pyetësorët ashtu dhe në diskutimet në fokus grupe u zbulua se për një pakicë të konsiderueshme, disa forma të dhunës janë normale ose justifikueshme dhe jo të dëmshme apo abuzive. Në këtë aspekt nuk është e vështirë të shihet se si qëndrimet dhe format jo fizike të dhunës mund të quhen normale dhe të tolerohen.

Atëherë, kur mendojnë burrat se forca fizike ndaj grave është e justifikueshme? Në studim, marrëdhëniet seksuale me dhunë kshin më shumë gjasa të konsiderohen si dhunë në familje nga të anketuarit në moshë më të vjetër. Ndërsa forca fizike ndaj gruas ose partnerit shihet si e justifikueshme në një shkallë më të vogël. Po ashtu, kontrolli i jetës sociale të partnerit duke i ndaluar kontaktet me familjen dhe miqtë, duke mos i lejuar akses në paratë familjare, shihet si dhunë në familje dhe çështje shumë serioze nga të anketuarit në moshë më të madhe.

Në të vërtetë në zonat ku papunësia e grave është e lartë dhe mekanizmat e mbështetjes janë inekzistent, mundësitë e grave për ti shpëtuar kontrollit dhe abuzimit janë të kufizuara në rastin më të mirë. (Këto pyetje kanë më pak relevancë për rinjtë). Kjo vërteton dhe gjetje nga hulumtime të tjera ku dhuna shfaqet si diçka që mund të anashkalohet, apo edhe justifikohet me arsyetimin si 'trashëgimi e kulturës " gjë që mund të çojë në një tendencë nga ana e burrave për të fajësuar gratë për dhunën ndaj tyre. "Unë nuk arrij të fitoj të ardhura për familjen time, vij në shtëpi i stresuar, ajo fillon sherrin ...Ta duroj?"

# MODELI I QENDRIMEVE?

Studimi siç pritej, pasqyron natyrën patriarkale të shoqërisë shqiptare. Për shembull, doli se rreth një e treta e djemve dhe burrave (si dhe 24% e vajzave) konsiderojnë gruan si pronë e burrit. Ne mund ti konsiderojmë këto qëndrime si pjese të trashëgimisë kulturore të lidhura me Kanunin që mbase do të shpërbëhen me kalimin e kohës.

Megjithatë, drejtimi që mund të marrin këto ndryshime shoqërore mund të mos jetë domosdoshmërisht në të mirën e përbashkët. Ky studim tregon për shembull, se edhe pse djemtë kanë një qëndrim më "modern" dhe ndërgjegjësim më të madh të barazisë gjinore se sa meshkujt, ata kanë më shumë gjasa për të mbështetur dhunën. Megjithatë, idetë e të qenit mashkull dhe qëndrimet ndaj gjinisë po ndryshojnë siç shihet dhe në dallimet midis gjeneratave të burrave dhe djemve.

## SOCIALIZIMI GJINOR

Punëtoritë hulumtuan mënyrat kryesore në të cilat djemtë zhvillojnë idetë e tyre, të kuptuarit e marrëdhënieve me vajzat dhe rolin e gruas në shoqëri dhe familje. Ndikuesit kryesore përfshijnë:

• Shkollat & Edukimi: Djemtë mendojnë se të kërkuarit ndihmë ose arritjet e mira në shkollë janë një tipar femëror. Ata mund të ndiejnë presion për të braktisur shkollën për të fituar të ardhura për të mbështetur familjen, dhe ka një uniformitet të modelit të mashkullit në klasë. Në të vërtetë si edhe ata deklaruan: "modelet që ne shohim në media, ata që kanë para dhe një jetë të mirë janë përgjithësisht pa shkollë… dhe ata që kanë shkollë, kanë aq sa ju duhet për të vepruar në botën e korrupsionit'.

• Media: media përforcon stereotipet e super-mashkullit. Kultura shqiptare mishëron modelin e burrit të suksesshem i cili shpërblehet për agresivitetin, ashpërsinë dhe mizogjininë. Shembuj të shumtë nga figurat publike në art, politikë dhe sport u përmendën në punëtori si shembuj tipike të këqinj të ofruar nga mediat.

• Shëndeti dhe Mirëqenia: Djemtë dhe burrat hezitojnë të kërkojnë ndihmë për çështjet e shëndetit, veçanërisht nëse ato lidhen me shëndetin seksual dhe mendor, apo edhe stresi emocional dhe presioni psikologjik.

# KËNDVËSHTRIMI I VAJZAVE

## NJË PERSPEKTIVË GJINORE

**Një gjetje disi shqetësuese, por jo e re, ishte niveli i lartë i pranimit të dhunës dhe DHBGJ nga vajzat.**

**Nuk dihet, dhe nuk ishte në fokus të studimit zbërthimi nëse kjo gjetje është pasqyrë e ekperiencave personale apo thjesht qëndrime.**

Megjithatë, nisur nga niveli i larte i DHBGJ dhe expozimi ndaj dhunës i vajzave dhe grave siç raportohet në të dhënat zyrtare, na bën të mendojmë se edhe mund të jetë.

Interesante është shkalla e larte e korrelacionit midis pergjigjeve nga vajzat, djemtë dhe burrat në Dibër, por jo në Durrës. Kjo mund të vijë si rezultat i strukturës demografike më homogjene në Dibër. Siç edhe u diskutua në punëtori burrat e Dibrës nuk i mirëpresin lehtë "jabanxhinjtë". Toka trashëgohet vetëm nga djemtë. Vajzat janë martuar jashtë, dhe "nuk ka punë dhandrri me ardh këtu. Kanuni nuk ta lejon!".

Edhe pse vajzat ishin më pak përkrahëse të dhunës se sa djemtë në të gjitha fushat, vajzat në Durrës rezultuan më të prirura për ta mbështetur dhunën se në Dibër. Kjo mund të mund të pasqyrojë si dinamikat e jetës urbane, kushtet socio-ekonomike po aq edhe faktorët kulturorë.

Megjithatë, mesazhi se DHBGJ nuk është vetëm fizike, mund ketë ndikim, pasi vetëm tek 5% e vajzave mendonin ndryshe. Gati 13% ishin të pavendosur, numer ky i afërt me studimin e mëparshëm.

Perceptimet e vajzave për meshkujt janë komplekse nisur dhe nga fakti që një numër më i lartë i vajzave krahasuar me djemtë u përgjigj me 'nuk e di'. Një pakicë në rritje i konsideron burrat agresivë nga natyra, por të dhënat tregojnë kundërshti mes tendencës në zona me 17% të vajzave në Durrës (4% në 2013) dhe 7% në Dibër (10% në 2013).

Një mesatare prej 31% mendojnë se është e drejtë për burrin ta mbrojë reputacionin me forcë dhe për 33% se është e drejtë të hakmerret (41% Durrës, 25% Dibër). Rreth 16% besojnë se dhuna mund të jetë një mënyrë për të shprehur ndjenjat. Ky mendim ishte dhe më i lartë tek vajzat në Durres me 19% në krahasim me 7% në 2013.

Edhe pse shumica mendon se një burrë nuk duhet të ngrejë dorën ndaj gruas, 22% e vajzave ishin të pavendosura për këtë çështje. Nuk kishte trend të qartë pasi në Durrës ky numer ra në 67% në krahasim me 91% ne 2013, ndërsa në Diber u rrit në 82% nga 70% në 2013.

Po ashtu, një minoritet vajzash beson se gruaja duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur familjen të bashkuar - Durrës 40%, Diber 29%. Kjo është dukshëm më e lartë se në studimin e mëparshëm (Durrës 13% dhe Dibër, 33%). Ç'është më e rëndësishmja, shumica e vajzave u përgjigj me 'nuk e di', nivel ky i ngjashëm të në të dy rajonet (53% në Durrës, 53% në Dibër).

Kjo tregon se ka nevojë të dukshme për të nxitur më tej fushatat informuese që adresojnë perceptimet e vajzave mbi barazinë gjinore dhe ndikimin e tyre mbi DHBGJ.

# RIKONCEPTIMI I ROLEVE GJINORE

Edhe pse qëndrimet ndaj përgjegjësive të barabarta ishin pozitive kjo nuk do të thotë se të anketuarit besojnë se rolet e burrave dhe grave duhet të jenë të njëjta apo dhe të mbivendosen.

Për shembull, 46% e meshkujve ose nuk mendojnë, ose nuk janë të sigurt se një burrë mund të kujdeset për fëmijët. Po kaq u shprehën se burri duhet të mbajë kontrollin financiar (40% djem, 43% burra), dhe se burri duhet të ketë fjalën e fundit në vendimet familjare (44% djem, 49% burra).

Edhe pse disa vajza nuk ishin të sigurta, gjysma i qëndronin besimit se burri duhet ti marrë vendimet e familjes. Shohim se vlerat dhe qëndrimet ndjekin ndryshimet demografike, pasi roli i grave ka ndryshuar dhe numri i grave kryefamiljare është në rritje.

Megjithatë, çështja e statusit të pabarabartë të grave ka rëndësi më të thellë për DHBGJ. Vlerat tradicionale që e shohin gruan si pronë janë të lidhur fort me qëndrimet që DHBGJ e konsiderojnë çështje familjare, jo shoqërore. Pyetja "kur një burrë dhe një grua martohet, gruaja bëhet pronë e burrit 'shkaktoi debate të nxehta, deri diku kontradiktore dhe mospranuese në punëtori.

Në anketë, 31% djem, 23% vajza; 35% e burrave u pajtuan, ku Dibra tregon një nivel dukshëm më të lartë të besimit sesa Durrësi. Në punëtori, kishte mospranim të disa përgjigjeve, reagim i njëjtë ky me studimin e vitit 2013.

Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve shprehën pikëpamjen se si burri e trajton gruan e tij është punë për të (33% djem, 28% vajza, 42% burra), ndjekur nga diskutimet e seminarit që DHBGJ është e perceptuar gjerësisht si një çështje e brendshme, jo një problem social. Kjo ka implikime sigurisht në fushatat që kanë për qëllim të sjellin ndryshim. Ky besim, jo rastësisht është i lidhur edhe me hezitimin për të ndërhyrë kur jemi dëshmitarë në DHBGJ.

Përpjekja për ta bërë DHBGJ një çështje private (kjo nuk është vetëm e tillë!) përjashton çdo detyrim për të vepruar dhe ndërhyrë. Për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të të dy gjinive, të qenit dëshmitarë të dhunës nuk është arsye e mjaftueshme për të vepruar, pavarësisht nga shkaku, pasi ata do të jenë shumë të frikësuar për të ndërhyrë.

Në Dibër, 9% e djemve dhe 15% e burrave nuk do flisnin apo vepronin, kundrejt 14% e burrave dhe 23% e djemve në Durrës. Shqetësuese është se një numër i madh i burrave ne Dibër 53% ishin të pasigurtë nëse do ndërhynin kundrejt 14% i burrave në Durrës. 12% e djemve dhe vajzave nuk e dinin ose ishin të pasigurtë në atë se çfarë duhet të bënin në një rast të tillë.

Në të vërtetë shembuj u përmendën në punëtori ku pjesëmarrësit kishin përjetuar një formë të DHBGJ, por nuk e kishin njohur atë si të tillë, dhe nuk e kishin menduar se ka nevojë për të ndërhyrë.

Një aspekt i evidentuar në punëtori për ata të cilët thanë se do të ndërhyjnë, ishe se dhe ndërhyrja propozohej të ishte e dhunshme. Ata që ishin më tolerantë ndaj dhunës ishin më të prirur të ndërhyjnë, po duke përdorur dhunë.

Kjo gjithashtu sugjeron nevojën për mbështetje informative dhe komunitare për mënyrën si të ndërhyhet pa rrezikuar si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për alternativat në ndihmë të viktimave të dhunës, si dhe ku të merret ndihmë dhe mbështetje.


37% E
DJEMVE
35% E
BURRAVE
MADJE DHE
23% E
VAJZAVE
BESOJNE
SE
GRUAJA
BEHET
PRONE
E BURRIT

# ARRITJA E NDRYSHIMIT

**Modernizimi vitet e fundit i kornizës ligjore dhe politikave është vend i mirë për të adresuar qëndrimet shoqërore, normat kulturore dhe sociale. Megjithatë, fakti që DHBGJ dhe pabarazia gjinore vazhdojnë te egzistojnë brez pas brezi tregon nevojën për veprim për të nxitur ndryshimin social. Ai thjesht nuk ka si të vijë ndryshe.**

Thelbi i këtij studimi është potenciali i nxitjes së një pakice të përkushtuar për të sjellë ndryshime sociale në komunitet. Disi në kundërshtim me atë që ne mund të supozojmë, për arritjen e ndryshimeve shoqërore me kalimin e kohës nuk kërkohet ndryshimi i menjëhershëm i mendimit të shumicës. Konsensusi social mund të ndryshohet shpejtë nga një pjesë relativisht e vogël aktivistësh të përkushtuar të shpërndarë rastësisht, të cilët në vazhdimësi sfidojnë mendimet e pranuara dhe vetë mbeten imun kundrejt ndikimit. Në fakt, teoria sugjeron se nevojitet vetëm 13% e popullsisë për të mundësuar momentin e ndryshimit.

Ky studim tregon se ka ndryshim të madh në mënyrën si formohen qëndrimet brenda dhe mes grupeve, madje edhe në grupet demografike homogjene. Kjo ka implikime për përpjekjet për të krijuar dhe mbështetur pakicat e përkushtuara, pasi nënkupton se njohja e qëndrimeve lokale, është rëndësishme për të identifikuar dhe angazhuar udhëheqësit dhe për të punuar me mekanizma ndikues me burrat dhe djemtë. Programe informative të targetuara mundësisht përmes edukimit dhe medias duket se ofrojnë mundësinë më të mirë për të nxitur një kulturë ku DHBGJ të mos jetë më më e pranueshme dhe aktivizmi të lulëzojë. Këto duhet të jenë disi të ndjeshme ndaj kontekstit lokal.

Kjo gjithashtu do të kërkojë që mesazhi të mos duket gabimisht manipulues apo edhe të ketë efekt të kundërt dhe duke shkaktuar rezistencë. Në vend të kësaj, përpjekjet që nxisin vetëdije dhe pranim të vlerave dhe mënyrës së jetesës janë më tërheqëse. Dhe siç tregohet në këtë studim, kontekstet lokale tregojnë dinamika të ndryshme, në rritje të shpejtë edhe në periudha të shkurtra kohore.

Por, vetëm informacioni, pa instrumenta të tjerë, ka ndikim të kufizuar nëse nuk përforcohet në mënyrë të përsëritur. Arsyetimi dhe racionaliteti nuk janë të mjaftueshme për të qenë bindëse, pavarësisht se sa mirë është argumentuar çështja. Pse? Ndoshta sepse sado evidencë të paraqitet, ajo injorohet lehtësisht nga natyra

njerëzore, e cila është rezistente ndaj ndryshimit dhe i trembet rrezikut të një risie.

Prandaj në vend që të fokusojmë ndërhyrjet në heqjen e asaj që është negative, ne duhet të theksojmë dhe të bëjmë lidhjen per aktivistët e mundëshëm me përfitimet pozitive. Kjo nënkupton përfshirjen në ideimin e programeve të një matricë përfitimesh pozitive ku të përfitojnë të dyja gjinitë.

Për shembull, ne mund ti bashkojme përfitimet prej mesazhit anti-DHBGj me qëllimet apo nevojat e grupeve, në një mënyrë që i inkurajon ata të kalojnë nga një rol i kufizuar në agjentë de facto për të drejtat e grave. Për këtë, më tej ofrohen disa ide ne këtë studim.



# REKOMANDIME

**Zhvillimet sociale, si psh. rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë, qeveri, shoqëri civile dhe punësim në Shqipëri ofrojnë një shembull të mirë se si barazia gjinore përmirëson shoqërinë.**

Megjithatë, ka ende nevojë për të siguruar që burrat dhe djemtë të bëhen aktivë në çështje të barazisë gjinore dhe kundër DHBGJ, përndryshe ne nuk do të jemi në gjendje të ndërtojmë mbi pikat e forta në njohuritë e DHBGJ për parandalimin, zbutjen dhe mbrojtjen.

Ndërsa ka ende nevojë absolute për të ruajtur një identitet të qartë për angazhimin e burrave dhe djemve - përndryshe ata nuk do të jenë në gjendje ta zotërojnë kauzen - rekomandimi thelbësor i raportit është që të zhvillohet një qasje gjinore më e sinkronizuar. Për këtë, programimi synon të arrijë një mbivendosje dhe kryqëzimin e përpjekjeve që prek të dyja gjinitë pavarësisht nga orientimi apo identiteti, duke përfshirë femrat si mbështetëse për aktivizmin e meshkujve dhe anasjelltas.

## ZHVILLIMI I LIDERSHIPIT

Ka potencial për të zhvilluar lidershipin brenda institucioneve vendore, të tilla si shëndetësia, arsimi, policia dhe komuniteti i biznesit. Një qasje e mundur është zhvillimi i strategjive mobilizuese shumë planëshe që mbështesin komunitetin në krijimin e një mjedisi me tolerancë zero ndaj dhunës në punë dhe mjedise publike.

Kjo mund të forcohet nga iniciativat që nxisin individët të shohin përtej kufijve të ngushtë profesionalë dhe të punojnë së bashku në gjetjen e mënyrave më të mira për të promovuar barazinë gjinore dhe anti-DHBGJ. [psh Manuali: Promovimi i Barazisë gjinore në programet e transfertave cash, ofron aktivitete edukative të fokusuara në barazinë gjinore për profesionistët dhe udhëheqësit komunitarë që punojnë me përfituesit e këtyre programeve.]

Jashtë kësaj, dhe në përputhje me nevojën për një qasje gjinore të sinkronizuar, ka ende potencial kryesisht të pashfrytëzuar për gratë dhe vajzat për të inkurajuar dhe mbështetur burrat në aktivizëm në nivelin komunitar të flasin dhe veprojnë kundër DHBGJ. Qasjet stimuluese mund të jenë të suksesshme, si psh. për shpërblime dhe njohje të arritjeve të djemve dhe burrave të cilët udhëheqin këto çështje në nivel lokal ose kombëtar.

## TË KUPTUARIT E SHQETËSIMEVE TË DJEMVE

Adoleshenca është një periudhë mundësish për ti angazhuar djemtë me barazinë gjinore. Kjo është një fazë e jetës, kur fillon eksplorimi i jetesës me pabarazitë sociale. Paraqitja e ideve mbi normat gjinore dhe angazhimi i djemve dhe të rinjve mund të ketë ndikime pozitive për gjithë jetën.

Por se si ta kanalizojmë këtë potencial në mënyrë sa më efektive mbetet ende problematike.

Shumica e pjesëmarrësve dhe të anketuarve djem deklaruan se ndikimi i fushatave mund të jetë efektiv në ngritjen e vetëdijes, por ato mbeten të kufizuara në përpjekjet për të ndryshuar qëndrimet ndaj dhunës. Ata theksuan se ndërhyrjet duhet të bëjnë përpjekje të veçantë për tu përqëndruar në punën me të rinjtë dhe për të rinjtë. Në këtë aspekt, lojëzimi i aktiviteteve në punëtori rezultoi një mjet të vërtetë i vlefshëm për të kapërcyer hezitimin, zhvilluar angazhimin dhe udhëheqjen. Këto teknika ofrojnë potencial të madh në qoftë se përfshihen si duhet më tej në programimin afatgjatë për ndryshim të qëndrueshëm.

Rinia shqiptare konsumon kohë të konsiderueshme dhe informacion në mediat e reja dhe rrjetet sociale. Në të vërtetë, jashtë shkollës dhe jetës familjare, interneti është gjithnjë e më shumë angazhimi më i madh për djemtë dhe vajzat. Iniciativat e fundit, sa të mirëpritura aq dhe të nevojshme, trajtojne fenomenin e ngacmimit në internet, dhe sugjerohet që praktika më e mirë të ndahet dhe të jetë pjesë e angazhimit të tyre.

Duke pasur parasysh dominimin, mediat e reja me të drejtë duhet të konsiderohen një mjedis shoqëror të cilin politikat anti-DHBGJ kanë nevojë ta analizojnë, kuptojnë, shfrytëzojnë dhe në fund të fundit influencojnë. E parë në aspektin e një teorie të ndryshimit, interneti paraqet rrezik dhe mundësi. Rrezik që veçanërisht shumë të rinj mund të jetë të ndjeshëm ndaj ngacmimeve dhe abuzimit në internet, pasi krimi mund të bëhet në anonimitet dhe mbetet pa u ndëshkuar.

Ka rreziqe të mëdha edhe në "edukimin seksual' të të rinjve apo influencimin nga fenomene të dëmshme të tilla si pornografia dhe ekstremizma të tjera. Megjithatë, ekziston mundësi e madhe pasi interneti ofron një medium të paparë përmes të cilit mund të angazhohet me cdo grupmoshë. Ka potencial të jashtëzakonshëm për risi në këtë hapësirë.

# ATËSIA DHE PËRKUJDESI

Ky studim konfirmon edhe një herë se transmetimi i normave gjinore dhe dhunës ndër breza ka rrënjë të thella. Prandaj është me rëndësi jetike për politikat dhe programet të informojnë dhe angazhojnë burrat në çdo rast që jepet. Një mënyrë si kjo mund të realizohet është duke marrë parasysh nevojat e burrave dhe djemve dhe duke siguruar mbështetjen përkatëse në faza të rëndësishme të jetës, të tilla si:

- Martesa: autoritetet civile, organizatat fetare dhe të tjerët të promovojnë mesazhe pozitive të atësisë dhe martesës, duke inkurajuar përkujdesin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta dhe të kujdesit, me informacione mbështetëse për ngritjen e familjes, ordinancat shtëpiake dhe ku mund të marrin ndihmë.
- Atësia: idetë mund të përfshijë informacion për baballarët e ardhshëm, promovimi i aktiviteteve që baballarët mund të bëjnë me fëmijët, rëndësinë e edukimit, mbështetje në ligjin e punësimit për leje atërore lindje.

Media ka një rol të rëndësishëm për të luajtur këtu gjithashtu. Jo vetëm në raportim të rasteve të dhunës, por dhe në theksimin e sanksioneve dhe mosmiratimin social në fushata masive mediatike që adresojnë dhunën ndaj grave.

Kjo mund të përfshijë:

- Trajnim për gazetarët dhe rritjen raportimit të historive të dhunës në familje në një mënyrë që zgjeron vetëdijen dhe inkurajon norma të larta të raportimit. (Shembull: Raportimi i lajmit të jepet bashkë me informacionin për kontaktin për ata që mund të preken nga çështjet e raportuara).
- Duke i përsëritur komunitetit në përgjithësi se dhuna është e papranueshme, pavarësisht nga rrethanat.
- Paraqitja e balancuar, përfaqësime moderne dhe analiza të rolit të meshkujve; dhe jo për të përforcuar ide e super-mashkullit ku mashkulli shpërblehet për agresivitetin, rezistencën, dhe mizogjininë.
- Promovimi i marrëdhënieve seksuale konsensuale për djemtë dhe vajzat, qofshin këto marrëdhënie heteroseksuale ose të të njëjtit seks.
- Ofrimi i informacionit për të drejtat dhe mbështetjen në dispozicion për ata që janë prekur nga dhuna duhet të nisë nga edukimi i medias në lidhje me të drejtat e njeriut.
- Shfrytëzimi i burimeve ekzistuese të tilla si "Udhëzuesi për burrat' nga PROMUNDO.

"FEMIJET E TU
DO BEHEN SI
TI. BEHU.
TI SI DO DOJE
QE TE BEHEN
ATA."

## SISTEMI ARSIMOR

Gjetjet e seminarit tregojnë se shkollat shqiptare dhe 'kultura' shkollore janë të papajisura për të siguruar hapësira të sigurta për djemtë, në mënyrë që të transformojnë ose të përshtatin normat, për të ushtruar ose përvetësuar sjellje më pozitive. Pasurimi i kurrikulave bazë me informacione mbi barazinë gjinore, si të buxhetohet ekonomia familjare, të drejtat sociale, përkujdesi, ndjeshmëri dhe planifikimin familjar mund të sjellin përfitime që do të vlejnë përgjatë gjithë jetës për të rinjtë. Ka modele ndërkombëtare që mund të pështaten, si psh. Rrënjët e Programit të Ndjeshmërisë (www.rootsofempathy.org).

Pabarazitë gjinore strukturale në shkolla do të trajtohen në mënyrë adeguate nëse ka koherencë mes asaj që është mësuar dhe mënyrës si është transmetuar kurrikula me qasje specifike gjinore. Përvec përmirësimeve ne shkolla, rritja e edukimit vërtetë gjithëpërfshirës kërkon që djemtë dhe burrat në familjet e tyre të kuptojnë rreziqet e hasura nga vajzat kur cungohen aspiratat, shkurtohet karriera arsimore si dhe të njohin nevojat e vajzave me aftësi të kufizuara për të mësuar.

Lidhur me këtë, zhvillimi i përkujdesit tek djemtë dhe nismat që synojnë ti japin fund dhunës ndaj fëmijëve dhe të nxitsin përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqëri mund të sjellin rezultat. (Ka rreth 120,000 fëmijë me të paktën një formë aftësie të kufizuar në Shqipëri, dhe harta e mbështetur nga UNICEF në 2011 identifikoi 6,304 fëmijë romë: UNICEF 2014). Iniciativat arsimore mund të përfshijnë:

- Ndërtimi i bazës informative me shembuj mbi qasjet më efektive të punës me djem të rinj dhe adoleshentë.
- Studim mbi dhunën dhe ngacmimet seksuale në shkolla dhe universitete.
- Edukim në grupe të strukturuara me djemtë në shkolla, mjedise sportive dhe komunitete.
- Zhvillimi i aktiviteteve sportive shkollore për vajzat. Vlerësimi për arritjet e vajzave dhe grave dhe pjesëmarrja në sport dhe kulturë në shkolla dhe media, sidomos në audienca me burra dhe djem.
- Hartimi i politikave arsimore që trajtojnē dhunën në baza gjinore. Shkolla përballet me shumë me pengesa në përgjigjen dhe mbështetjen ndaj nxënësve, pasi çështjet personale dhe familjare të nxënësve shpesh mund të shfaqen në formë dhune në shkollë.
- Arritje angazhimi të qëndrueshëm dhe kthimi i studimieve në hapa konkrete aktivizmi përmes zhvillimit të një portali arsimor dhe pilotimi i një lëvizje barazie gjinore GEMS në shkolla.
- I tillë mund jetë edhe miratimi i Programit H në nivel ministror. Program H konsiderohet si praktikë e mirë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore (WM, OBSH, UNICEF, UN, UNDP, UNFPA). Ky program është miratuar zyrtarisht nga ministritë e shëndetësisë në Brazil, Meksikë, Kili, dhe Kroaci, por dhe në vende të tjera. (Për shembuj të zhvillimit të lidershipit tek të rinjtë, shih www.expectrespectaustin.org).

Ndërsa shkollat dhe universitetet janë ambjente natyrale, të mundëshme për zbatim iniciativash, duhet të mos harrojmë se ky proces duhet të udhëhiqet nga vetë të rinjtë. Kjo do kërkojë përgatitje shtesë për trajnimin e specialistëve të edukimit.

## RIPERCAKTIMI I ROLEVE

Punëtorite u dhanë mundësinë djemve të reflektojnë në modelet tipike që ata kanë, dhe një pjesë e mirë i konsideron ato uniforme dhe jo diverse. Ndikimi i modeleve ndërkombëtare duket i kufizuar mbase për shkak se barriera gjuhësore do të thotë se lajmet dhe mediat ndërkombëtare arrijnë zakonisht vetëm përmes filtrave të medias shqiptare. Fushatat kundër GBV mund të ndihmojnë këtu duke ofruar një shumëllojshmëri të modeleve për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrimeve të burrave dhe djemve.

Djemtë në veçanti janë subjekt i normave shoqërore që nxisin agresionin verbal dhe fizik, injorojnë nevojën për shëndetin dhe sjelljet që kërkojnë ndihmë. Kjo padyshim ndikon tek shëndeti dhe mirëqënia emocionale e djemve gjatë gjithë jetës. Në të kundërt, djemtë, baballarët e të cilëve kanë rol në detyrat e përkujdesjes dhe në punë shtëpie janë më të prirur që dhe ata të jenë të tillë kur të rriten. Prindërimi i angazhuar, mbështetës dhe jo i dhunshëm mund të shërbejë si ndërmjetës për ndikimin ne komunitet dhe familje lidhur me zhvillimin e fëmijës, si dhe ul rreziqet e dhunës, ngacmimit dhe ndërmarrjen e rrezikut në adoleshencë.

Angazhimi i djemve është pjesë integrale në reduktimin e stigmës dhe diskriminimit ndaj atyre që identifikohen si LGBTQI. Përkufizimet e ngurta të të qenit mashkull pengojnë aftesinë ndihmë kërkuese tek djemtë, pengojnë rritjen personale dhe e bën jashtëzakonisht të vështire për djemtë të ngrihen kundër abuzimit, homofobisë dhe shfrytëzimit seksual ndër të tjera. Në përgjigje të kësaj, edukimi seksual gjithëpërfshirës bazuar në të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore mund të inkurajojë rivlerësim të 'burrërisë' për djemtë. Si djemte dhe vajzat përfitojnë nga këto njohuri specifike, aftësi dhe ndërgjegjësim, dhe më e rëndësishmja vlerësimi për qasje të shëndetshme ndaj seksualitetit, marrëdhënieve dhe mirëqenja në përgjithësi.

## DHUNA

Nivelet e larta të justifikimit të dhunës, veçanërisht ajo ndëshkuese, janë të pritëshme duke ju referuar traditave zakonore në Shqipëri. Në këtë studim të dytë ato u shfaqën më fuqishëm. Po ashtu, ky qëndrim lidhet me gjetjen se shumica e pjesëmarrësve të punëtorive i konsiderojnë dënimet për dhunë jo mjaft të forta. Këto sugjerojnë se fushatat duhet të përforcojnë një mesazh të përgjithshëm anti-dhunë. Është e rëndësishme që burrat dhe

djemtë janë në dijeni të burimeve alternative, duke u përfshirë qoftë si kalimtarë, apo duke 'i dhënë drejtim vetë' situatave.

Në mënyrë të ngjashme, programet e referimit të djemve dhe burrave ushtrues të dhunës në programet e DHBGJ të bazuara në komunitet mund të trajtojnë shkaqet rrënjësore dhe parandalimin e ri-shfaqjes.

Përpjekjet për të eliminuar DhBGJ duhen shtuar natyrisht, për të arritur një sërë rezultatesh nga ngritja e ndërgjegjësimit për ligjet aktuale tek forcimi i sistemit të mbrojtjes. Siç u vu në dukje, për dhunën në familje përpjekjet mund të përqëndrohen në thyerjen e transmetimit të normave të dhunës ndër breza përmes edukimit. Institucionet e tjera kanë gjithashtu një rol dhe lehtësimi mund të bëhet duke angazhuar institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile me trajnime profesionale për mësuesit, por në disa raste mund të ketë nevojë për trajnim për punonjës socialë, policinë, avokatët dhe personelit mjekësor, me raport të drejte kosto impakt duke përfshirë një element mbështetës, ku mjetet dhe trajnimi bëhen brenda në organizata si 'trajnim trajneri'.

• Jashtë Shqipërisë, ndërhyrjet në qëndrimet mosangazhuese, siç është shtjelluar në këtë studim, përfaqësojnë një ndryshim në metodologji e punës me burrat në parandalimin e dhunës. Këto mund të adresohen nga këshillimi i burrave dhe djemve të prekur koordinuar me trajnim institucional.
• Po ashtu, shumica e ndërhyrjeve fokusohet tek djemtë dhe burrat në përgjithësi, por një pjese e mire e tyre nuk janë autorë dhune, dhe si të tillë kanë gjasa ta injorojnë mesazhin pasi s'ka lidhje direkte me ta.

*(vijon në faqen 46)*

# ANGAZHIMI ME SHQETËSIMET E BURRAVE

Një gjetje e re nga ky studim është se përparimi në angazhimin burrave dhe djemve kundër DHBGJ mund të jetë i komplikuar apo edhe në rrezik prej shqetësimeve të vazhdueshme për mirëqenie social-ekonomike. Dihet tashmë që periudhat e uljes ekonomike dhe pasigurise promovojnë ndjenja sociale më konservatore.

Pjesëmarrësit e punëtorive veçanërisht burrat, cituan vështirësitë monetare dhe 'meraqet' si arsye për të mos u angazhuar apo mosadresuar çështjet e DHBGJ qofshin keto në nivel programi apo në atë individual. Ne vumë re rolin e rëndësishëm që ka ende Kanuni tek pjesëmarrësit në Dibër, gjë që nuk u shfaq ndjeshëm në studimin e mëparshëm.

Një vëzhgim më i thellë zbulon se shkaku i rritjes së presionit mbi burrat vjen pikërisht nga sistemi i vlerave që ata përpiqen të mbrojnë dhe mbajnë, në të cilin është kryesisht detyra e burrit të sigurojë të ardhura për familjen. Rritja e stresit me të cilin përballen burrat "që jetojnë në frikën se kanë dështuar në detyrën ndaj familjes" pa dyshim ka ndikim në mënyrën si gratë ushtrojnë të drejtat e tyre në marrëdhëniet familjare. Pikërisht në ditë të vështira burrat dhe gratë duhet të bashkohen për të përballuar problemet. Parë në këtë aspekt, ne mund të shohim se shqetësimi i tyre me të vërtetë bëhet një argument më shumë për angazhimin, miratimin e normave të reja gjinore dhe largimin e dallimeve.

Për këtë arsye ka nevojë reale për burime që të mbështesin më shumë ndarjen e roleve dhe përgjegjësive në familje. Ne botë, fuqizimi ekonomik për gratë ka patur më shumë sukses kur ka qenë i shoqëruar  me një mesazh kundër dhunës. Kjo mund të jetë në formën e informacionit apo promovimin e mundësive dhe mjeteve të jetesës për gratë, punësimin dhe shërbimet e trajnimit, ose menaxhimin e shtëpisë apo financat e përbashkëta.

Megjithatë, nisma të tilla do të duhet të sjellin bashkë në diskutime gratë dhe burrat, në lidhje me rëndësinë e vendimeve për ndarjen e financave shtëpiake, kujdesin ndaj fëmijëve, puna në familje, për të siguruar që ndryshimet ekonomike dhe sociale janë tërësore dhe të qëndrueshme. Për këtë qëllim, promovimi i fuqizimit ekonomik të grave arrihet duke angazhuar burrat si aleatë në transformimin e qëndrimeve të dëmshme gjinore dhe sjelljet që ndikojnë progresin. Meqenëse pabarazitë socio-ekonomike përkeqësojnë pabarazitë gjinore, informacioni mbi ligjin e punësimit, ndalimi i punësimit informal dhe edukimi i të drejtave të vazhdueshme kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm për të luajtur.

Ne shikim të parë kjo duket se përbën nje argument të fortë për eksplorimin e lidhjeve të mëtejshme ndërmjet barazisë gjinore dhe mbrojtjes sociale, si dhe për fokusim të aktiviteteve kundër DHBGJ  pikërisht në familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet e margjinalizuara. Një sistem shoqëror që mbron të gjithë qytetarët në çdo moment të jetës që bien në vështirësi kundrejt një sistemi që është i bazuar tek përjashtimi, është e sigurt që do të sjellë më shumë rezultate pozitive në dinamikën familjare. Studime të mëtejshme në marrëdhëniet mes DHBGJ dhe çështjeve socio-ekonomike mund jenë bazë për fushatat e ardhshme.

Pra, qëndrimet janë vendimtare për angazhimin e tyre, pasi kjo është pika ku burrat mund të tregojmë rëndësinë, dhe rolin për si aleatë, si dhe të kultivojnë përkushtimin e tyre dhe kapacitetin për parandalim dhe ndërhyrje në situata dhune. Kjo bën thirrje për një studim në numër më të madh, por me fokus te ngushte në qëndrimet mosndërhyrëse, qëllimet, efikasiteti i ndërhyrjes me qëllim për të zhvilluar mjete dhe rrjete mbështetëse.

Fushatat e edukimit duhet të ulin pasigurinë në lidhje me atë se cfarë është dhuna dhe format e saj, duke siguruar informacion të bazuar në fakte për të kundërshtuar mitet dhe besimet e pasakta të cilat mund të ekzistojnë brenda komunitetit.

Ekziston gjithashtu nevoja për të dhënë një mesazh të qëndrueshëm, të saktë dhe të qartë në lidhje me përhapjen e DHBGJ, si dhe ndikimet e saj. Theksi duhet t'i jepet si mund të raportohet DHBGJ dhe udhëzimi duhet të informojë se çfarë ndihme ofrohet. Në këtë drejtim, ne duhet të mbetemi të ndërgjegjshëm se ndërhyrjet me forcë qofshin ato personale apo dhe komunitare nuk funksionojnë.

Përveç edukimit të komunitetit, ka edhe një sërë faktorësh më individuale, organizative, komunitarë dhe nivele shoqërore që kontribuojnë në formimin e qëndrimeve të komunitetit ndaj dhunës kundër grave (p.sh. ekspozimi ndaj dhunës në fëmijëri, disa mjedise organizative dhe moshatarësh).

Kjo tregon rëndësinë për të eksploruar një gamë të gjerë të strategjive të ndërhyrjes së hershme dhe koordinimin e vetëdijes dhe iniciativat arsimore në nivel kombëtar dhe lokal. Të diturit se ku të shkojnë për ndihmë që është e sigurt se do tu ofrohet, duhet të jetë pjesë e planifikimit të strategjive.

Ka potencial për promovimin e modeleve pozitive lokale nga njerëzit më të pjekur (në moshë) që sjellin mesazhin anti-dhunë në komunitetet e tyre, si dhe për forcimin e sanksioneve ligjore dhe sociale në rastet e DhBGj.

A ju duhet dhënë një rol dhe më shumë hapësirë gjyshërve? Mësuesve? Trajnerëve? Modelet ndikuese lokale ishin lehtësisht të identifikueshme nga pjesëmarrësit në këtë studim që tregon se njerëzit tashmë kanë pika referimi lokale, por se ata duhet të mbështeten dhe mesazhi i tyre të forcohet.

Së fundi, ka mangësi serioze në të dhëna dhe njohuri, dhe hartuesit e politikave dhe programeve do përfitonin nga kërkime të mëtejshme në këto fusha kryesore:

• Dhuna sipas grupeve, prejardhjes së pakicave, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

• Një studim kombëtar në dhunën adoleshente dhe të re. Mungesa e të dhënave fsheh përhapjen e saj dhe ndalon çdo përgjigje politike ndaj kësaj çështje. Studimi mund analizojë nevojat e të rinjve, si viktimat dhe dhunuesit, si dhe përvojat e të rinjve me dhunën.

• Ka nevojë për më shumë të dhëna mbi nivelet dhe përhapjen e dhunës mes të rinjve, dhe në mes djemve dhe baballarëve.

TANI E KE FJALEN TI.

# JEPE FJALEN! NDIHMO NE NDALIMIN E DHMBGJ!

# BIBLIOGRAFI


ACQUIRE Project/EngenderHealth and Promundo (2008) Engaging Boys and Men in Gender Transformation: The Group Education Manual (http://www.westcoastmen.org/sites/default/files/engaging_boys__men_in_gender_transformation.pdf).

Albanian State Police (2016) Statistika per dhunen ne familje per vitin 2015 dhe 6mujorin e pare 2016, Albanian State Police,

Barker, G., Greene, M., Nascimento, M., Segundo, M., Ricardo, C., Taylor, A., Aguayo, F., Sadler, M., Das, A., Singh, S., Figueroa, J. G., Franzoni, J., Flores, N., Jewkes, R., Morrell, R. and Kato, J. (2012) Men Who Care: A Multi-Country Qualitative Study of Men in Non- Traditional Caregiving Roles. Washington, D.C.: International Center for Research on Women (ICRW) and Rio de Janeiro: Instituto Promundo.

Barker, G., Contreras, J.M., Heilman, B., Singh, A.K., Verma, R.K., and Nascimento, M. (2011) Evolving Men: Initial Results from the International Men and Gender Equality Survey (IMAGES). Washington, D.C.: International Center for Research on Women (ICRW) and Rio de Janeiro: Instituto Promundo.

Barker,G., Nascimento, M., Segundo, M., Pulerwitz,J. (2003) How do we now if man have changed? Promoting and measuring attitude change with young men', In S. Ruxton (ed.), Lessons from Program H in Latin America, Gender Equality and Men. Oxford: Oxfam.

Barker, G.(2005) Dying to be men. Youth, masculinity and social exclusion. Oxon: Routledge.

Cincotta, R., Engelman, R., Anastasion, D. (2003) The security demographic: Population and Civil Conflict after the Cold War. Washington DC: Population action International.

Connell,R.W.( 1994) Masculinities. Berkeley, CA: University of California Press.

Connell, R. (2007) Masculinities, Power, Epidemic: Messages of social research. Avaliable at: http:/siyanda.org/docs/connell_epidemic.doc

Deaux, K., Lafrance, M. (1998) Gender. In Gilber, D. T., Fiske, S. T. & Gardner, L.: The handbook of social psychology, Vol 1, New York: McGraw-Hill, 788-818

Eckman, A., Jain, A., Kambou, S.D., Crownover, J., Prvulović, M., Dušanić, S., Matkovic, V., Husić, A. (2007) Exploring dimensions of masculinity and violence. Banjaluka: Care International, ICRW.

Fleming, J. P, Barker, G, McCleary-Sills, J., Morton, M. (2013) Engaging men and boys in advancing women's agency: Where we stand and new directions, Women's Voice, Agency, & Participation Research Series No.1.

ICRW, International Center for Research on Women (2010) Men and Gender Equality Policy Project "What Men have to do with it: Public Policies to Promote Gender Equality" (http://www.icrw.org/files/publications/What-Men-Have-to-Do-With-It.pdf)

ICRW, International Center for Research on Women (2008) Seven priorities, Seven years to go: Progress on achieving Gender Equality. Washington DC: ICRW.

Kato-Wallace, J., Barker, G., Sharafi, I., Mora, I., Lauro, G. (2016) Adolescent boys and young men: Engaging Them as supporters of Gender Equality and health and understanding their vulnerabilities. Washington, D.C.: Promundo-US. new york City: UNFPA.

Mens Resources International (2013) Strategies and Skills for Engaging Men And Boys In Gender-Based Violence Prevention.

Myers, D.G. (1993) Social psychology, McGraw-Hill

Pawlak, P. and Barker, G. (2015) Hidden Violence - Preventing and responding to sexual exploitation and sexual abuse of adolescent boys. Case Studies and Directions for Action

Tahiraj, E. (2008) May my wife life long! Research paper in Gender and Social Change in Albania's Transition. Amsterdam: Cordaid.

UNFPA: Partnering: A New Approach to Sexual and Reproductive Health (2015) www.unfpa.org.
WHO (2007) Engaging men and boys in changing gender-based inequity in health: Evidence from programme interventions. Geneva. Available at: http:/ www.who.int/gender/documents/engaging_men_boys.pdf.

UNICEF (2014) Analysis of policies and reforms affecting the situation of children in Albania. UNICEF Albania.

UNWOMEN (2013) Measuring Gender Attitude: Using Gender-Equitable Men Scale (GEMS) in Various Socio-Cultural Settings, in Making Women Count An Annual Publication on Gender and Evaluation by UN Women Multi Country Office for India, Bhutan, Sri Lanka and Maldives. www.unwomen.org.

WWW. FJALEBURRI .NET

2FJALEBURRI